




Demokracia në Veprim
Demokratija na Delu
Democracy in Action

RAPORTI I MONITORIMIT TË MEDIAVE GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE

ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME PËR
KUVENDIN E KOSOVËS

9 SHKURT 2025



RAPORTI I MONITORIMIT TË MEDIAVE GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE

**ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME PËR
KUVENDIN E KOSOVËS**

Përgatitur nga: Demokracia në Veprim (DnV)

Dizajn: ENVINION

Të drejtat e autorit ©2025. Demokracia në Veprim (DnV).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç citimeve të pjesëve të shkurtra me qëllim të kritikës dhe rishikimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të rikthimit të të dhënave, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjeti, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistrues ose tjetër, pa lejen paraprake të DnV.

Përmbajtja

LISTA E SHKURTESAVE	7
PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	8
METODOLOGJIA	9
KORNIZA LIGJORE PËR MEDIAT GJATË ZGJEDHJEVE	11
TË DHËNAT E PËRGJITHSHME NGA MONITORIMI	13
KRONIKAT ZGJEDHORE	13
DEBATET TELEVIZIVE	16
TRANSMETIMET E DREJTPËRDREJTA NGA PORTALET	19
MONITORIMI I FAQEVE ZYRTARE TË FACEBOOK-UT TË KANDIDATËVE PËR KRYEMINISTËR	19
MONITORIMI I FAQEVE ZYRTARE TË FACEBOOK-UT TË SUBJEKTEVE POLITIKE	20
GJETJET INDIVIDUALE NGA MONIOTRIMI I TELEVISIONE	21
RADIO TELEVISIONI I KOSOVËS	22
KRONIKA ZGJEDHORE	22
DEBATET TELEVIZIVE	24
KOHAVISION	25
KRONIKA ZGJEDHORE	25
DEBATET TELEVIZIVE	27
KLAN KOSOVA	28
KRONIKA ZGJEDHORE	28
DEBATET TELEVIZIVE	30
RADIO TELEVISIONI 21 (RTV 21)	31
KRONIKA ZGJEDHORE	31
DEBATET TELEVIZIVE	33
RTV DUKAGJINI	34
KRONIKA ZGJEDHORE	34
DEBATET TELEVIZIVE	36
T7	38
KRONIKA ZGJEDHORE	38
DEBATET TELEVIZIVE	40
KANAL 10	41
KRONIKA ZGJEDHORE	41
DEBATET TELEVIZIVE	43

TËVË 1	44
KRONIKA ZGJEDHORE	44
DEBATET TELEVIZIVE	46
ATV	47
KRONIKA ZGJEDHORE	47
DEBATET TELEVIZIVE	49
RADIO TELEVISIONI I KOSOVËS 2 (RTK 2)	51
KRONIKA ZGJEDHORE	51
DEBATET TELEVIZIVE	54
TV PULS	55
KRONIKA ZGJEDHORE	55
TRANSMETIMET LIVE NË RRJETIN SOCIAL 'FACEBOOK'	57
MONITORIMI I FAQEVE ZYRTARE TË FACEBOOK-UT TË	
KANDIDATËVE PËR KRYEMINISTËR	59
MONITORIMI I RRJETIT SOCIAL "FACEBOOK" - LUMIR ABDIXHIKU	60
MONITORIMI I RRJETIT SOCIAL "FACEBOOK" - ALBIN KURTI	60
MONITORIMI I RRJETIT SOCIAL "FACEBOOK" - BEDRI HAMZA	60
MONITORIMI I RRJETIT SOCIAL "FACEBOOK" - RAMUSH HARADINAJ	60
MONITORIMI I FAQEVE ZYRTARE TË FACEBOOK-UT	
TË SUBJEKTEVE POLITIKE	61
7. JO-FUNKSIONALITETI I KOMISIONIT TË	
PAVARUR TË MEDIAVE GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE	63
8. MONITORIMI I DITARËVE TË DORËZUAR NË KPM NGA OSHM-ËT	64
DITARËT E DORËZUAR NGA RADIO TELEVISIONI I KOSOVËS 1	65
DITARËT E DORËZUAR NGA KOHAVISION	65
DITARËT E DORËZUAR NGA KLAN KOSOVA	66
DITARËT E DORËZUAR NGA RADIO TELEVISIONI 21	66
DITARËT E DORËZUAR NGA RTV DUKAGJINI	66
DITARËT E DORËZUAR NGA T7	67
DITARËT E DORËZUAR NGA KANAL 10	67
DITARËT E DORËZUAR NGA TËVË 1	67
DITARËT E DORËZUAR NGA RADIO TELEVISIONI I KOSOVËS 2	68
9. REKOMADIME	69

LISTA E SHKURTESAVE

OShM	Ofruesit e Shërbimeve Mediale
KPM	Komisioni i Pavarur i Mediave
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
AGK	Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
DnV	Demokracia në Veprim
LVV	Lëvizja Vetëvendosje
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
SDU	Bashkimi Social Demokrat (Social Demokatska Unija)
PDAK	Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës
Koalicioni AKK - NISMA	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA Socialdemokrate, Konservatorët, Intelektualët
RTK 1	Radio Televizioni i Kosovës 1
RTK 2	Radio Televizioni i Kosovës 2
KTV	Kohavision
RTV 21	Radio Televizioni 21
T7	Televizioni 7

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Monitorimi i mediave gjatë fushatës zgjedhore është një komponentë kyçe për vlerësimin e transparencës dhe paanshmërisë së mbulimit mediatik. Ky raport, i përgatitur nga Demokracia në Veprim (DnV), analizon hapësirën e dedikuar për subjektet politike dhe kandidatët në mediat tradicionale dhe ato sociale gjatë periudhës zgjedhore (11 janar - 8 shkurt 2025).

Ky raport synon të ofrojë një bazë të fuqishme për përmirësimin e transparencës dhe barazisë në mbulimin mediatik të zgjedhjeve në të ardhmen. Në pjesën në vijim, do të paraqiten gjetjet kryesore të këtij raporti të monitorimit:

DEBATET TELEVIZIVE

Nga 409 debatet e zhvilluara gjatë kësaj fushate zgjedhore, dominojnë ato vetëm me një subjekt politik (223 debate), pasuar nga debatet vetëm me analistë (131 debate).

Gjatë kësaj fushate vërehet mungesa e ballafaqimit të subjekteve politike, ku vetëm 47 debate përfshinin ballafaqime mes subjekteve (34 debate me shumë subjekte, dhe 13 debate në mes dy subjekteve).

Pjesëmarrja e grave në debate ishte vetëm 21%, ndërsa pjesëmarrja e kandidatëve burra 79%.

KRONIKAT ZGJEDHORE

Gajtë periudhës së fushatës zgjedhore, u transmetuan rreth 69 orë kronika zgjedhore në 11 televizione.

LDK dhe PDK kishin mbulim më të lartë (791 dhe 762 minuta), ndërsa Lista Serbe kishte vetëm 103 minuta.

Kandidatët për kryeministër patën 1123 minuta ekspozim, ndërsa kandidatët e tjerë për deputetë vetëm 547 minuta.

Përfaqësimi i grave ishte i ulët: vetëm 16% e kronikave përfshinin gra, ndërsa pjesa tjetër (84%) ishte e dedikuar për kandidatët burra.

PORTALET DHE TRANSMETIMET LIVE

Gjatë fushatës zgjedhore janë monitoruar 15 faqe zyrtare të portaleve në Facebook. Gjatë kësaj kohe ishin publikuar 293 transmetime të drejtpërdrejta nga portalet, që përfshinin 18,000 minuta mbulim.

Këto portale kanë transmetuar 305 orë e 4 minuta në faqet e tyre zyrtare. Prej kësaj hapësire, AAK-NISMA ka pasur 205 orë e 53 minuta, LDK 55 orë e 22 minuta, PDK 37 orë e 44 minuta, LVV 5 orë e 58 minuta, dhe subjektet tjera 7 minuta.

Mungesa e transparencës mbi sponsorizimin e këtyre transmetimeve ishte vënë re në pjesën më të madhe të transmetimeve live.

AKTIVITETI NË RRJETIN SOCIAL “FACEBOOK” DHE FAQET ZYRTARE

Kandidatët për kryeministër postuan 579 postime në rrjetin social “Facebook”, ku Lumir Abdixhiku (LDK) udhëhoqi me 188 postime.

Faqet zyrtare të partive politike publikuan 1615 postime, ku më së shumti prej tyre kishte LVV (403 postime).

DnV rekomandon garantimin e përfaqësimit proporcional dhe të drejtë të kandidatëve dhe subjekteve politike në media, shmangien e lajmeve të njëanshme dhe gjuhës së urrejtjes, si dhe përsheptimin e emërimit të anëtarëve të rinj të KPM për funksionalizimin e institucionit.

Gjithashtu, kërkohet rritja e mbikëqyrjes ndaj mediave tradicionale dhe online për respektimin e standardeve profesionale, sigurimi i transparencës në financimin e mediave dhe reklamave politike për të shmangur ndikimin e grupeve të interesit, si dhe ofrimi i udhëzimeve dhe trajnimeve nga KPM për OShM-të mbi përgatitjen dhe dorëzimin e ditarëve të transmetimit.

METODOLOGJIA

Monitorimi i mediave dhe hapësirës që ato u dedikojnë subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore përbën një aspekt kyç të misionit të Demokracisë në Veprim (DnV). Ky proces përfshin një analizë të detajuar të mediave tradicionale dhe atyre sociale, duke synuar të vlerësojë transparencën, paanshmërinë dhe qasjen e barabartë në mbulimin e aktiviteteve zgjedhore.

Monitorimi i mediave tradicionale dhe sociale gjatë fushatës është bërë në këto fusha:

- Sa kanë pasur hapësirë kandidatë/et e subjekteve politike në media;
- Sa kanë pasur mediat hapësire dedikuar për zgjedhje në aspektin informativ;
- Sa kanë pasur hapësirë mediat dedikuar spoteve reklamuese dhe transmetimet e drejtpërdrejta të tubimeve të subjekteve politike;
- Sa kanë shkuar portalet në formatin ‘Livestream’, të cilat janë transmetuar përmes Facebook-ut;
- Janë monitoruar faqet zyrtare të Facebook-ut të subjekteve politike si dhe
- Janë monitoruar faqet zyrtare të Facebook-ut të kandidatëve për kryeministër

Monitorimi ka përfshirë analiza të debateve televizive, kronikave zgjedhore, spoteve reklamuese, transmetimeve ‘live’ nga portalet dhe rrjeteve sociale, duke filluar nga 11 janari deri më 8 shkurt 2025, që përkon me të gjithë periudhën zyrtare të fushatës zgjedhore.

PERIUDHA DHE KOHA E MONITORIMIT

- Televizionet – Kronikat zgjedhore janë monitoruar nga ora 17:00 deri në 00:00, ndërsa debatet televizive nga ora 20:00 deri në 00:00, gjatë “prime time”, kur shikueshmëria është më e lartë.
- Rrjetet sociale dhe portalet – Monitorimi i faqeve zyrtare të subjekteve politike dhe kandidatëve për kryeministër në Facebook, si dhe i transmetimeve “live” nga portalet, është kryer në një periudhë 24-orëshe, duke reflektuar natyrën e pandërprerë të aktivitetit në platformat online.

PËRZGJEDHJA E TELEVIZIONEVE

Gjatë fushatës elektorale janë monitoruar nëntë televizione në gjuhën shqipe dhe dy televizione në gjuhën serbe, bazuar në kriteret e shikueshmërisë dhe shtrirjes së tyre në tërë territorin e Kosovës.

Televizionet e përzgjedhura për monitorim janë:

- Televizionet publike: RTK 1 (gjuhë shqipe) dhe RTK 2 (gjuhë serbe).
- Televizionet private: KTV, RTV 21, Klan Kosova, TV Dukagjini, T7, Kanal 10, Tëvë 1, ATV dhe TV PULS (gjuhë serbe).

Monitorimi në këto televizione është fokusuar në:

- 1 Kronikat zgjedhore – Si është mbuluar fushata në edicionet informative?
- 2 Debatet televizive – Sa ka qenë pjesëmarrja e barabartë e subjekteve politike në emisionet zgjedhore?

MONITORIMI I PORTALEVE

Duke marrë parasysh trendin e rritjes së ndikimit të rrjeteve sociale dhe rolit të portaleve në transmetimin e aktiviteteve politike, monitorimi i faqeve zyrtare të portaleve në Facebook është konsideruar i domosdoshëm. Këto platforma, falë numrit të lartë të ndjekësve, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në transmetimin e drejt-përdrejtë të tubimeve të subjekteve politike gjatë fushatës.

Portalet e monitoruara gjatë kësaj fushate kanë qenë:

- Telegrafi, Koha.net, GazetaExpress, RTKlive, Nacionale, Periskopi, Demokracia, Ekonomia online, Indeks online, Gazeta Blic, Albanian Post, Insajderi, Paparaci, Sinjali, Kosovapress, TV Most, TV KIM.

Ky proces monitorimi ka synuar të vlerësojë objektivitetin dhe balancimin e mbulimit mediatik, duke identifikuar hapësirën e dedikuar për secilin subjekt politik dhe duke analizuar ndikimin e mediave tradicionale dhe dixhitale në formësimin e opinionit publik gjatë fushatës zgjedhore.

MONITORIMI I RRJETIT SOCIAL “FACEBOOK”

Rrjetet sociale të monitoruara kanë përfshirë vetëm platformën 'Facebook' për shkak të aktiviteteve të ulëta në rrjetet tjera sociale.

Analiza e monitorimit është e përqendruar tek aktiviteti që kanë pasur subjektet politike dhe kandidatët e tyre për kryeministër në rrjete sociale, sa i kanë përfshirë kandidatet gra nga radhët e subjekteve të tyre. Ky monitorim ka përfshirë datat 11 janar - 8 shkurt 2025. Gjithashtu janë monitoruar rrjetet sociale të kandidatëve për kryeministër në periudhën e parafushatës nga 1 shtatori deri me 31 dhjetor 2024.

KORNIZA LIGJORE PËR MEDIAT GJATË ZGJEDHJEVE

Në një shoqëri demokratike, liria e shprehjes dhe e mediave është themeli për garantimin e një debati publike të hapur dhe pluralist, i bazuar në parimet e sundimit të ligjit dhe të drejtat themelore të qytetarëve. Rrjedhimisht, **Kushtetuta e Republikës së Kosovës** e garanton lirinë e shprehjes dhe lirinë e mediave në nenin 42 të saj, duke krijuar kështu një bazament të fuqishëm për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Përveç Kushtetutës, organi ligjvënës ka sjellë edhe një varg ligjesh dhe aktesh nënligjore që e rregullojnë sferën e mediave.

Kësisoj, **Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave**¹, i cili është miratuar në mars të vitit 2012, ka për qëllim përcaktimin e kompetencave të Komisionit të Pavarur të Mediave (në tekstin e mëtejshëm: KPM) me qëllim të promovimit të zhvillimit të një tregu të shëndoshë të shërbimeve mediale audio-vizuele, që u shërben të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Sipas nenit 3 të këtij ligji, KPM-ja është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuele, duke përfshirë edhe mediat online. Politika e transmetimit, siç përcaktohet nga ligji, duhet të përputhen me standardet ndërkombëtare të transmetimit dhe të respektojnë të drejtat e njeriut. Në këtë kontekst, normat evropiane, përfshirë Direktivën AVMS të Komisionit Evropian, përcaktojnë kryesisht mënyrën e ruajtjes së demokracisë, sundimit të ligjit dhe lirisë së shprehjes në hapësirën mediatike.

Në dhjetor të vitit 2024, KPM ka nxjerrë **Rregulloren për Obligimet e Ofruesve të Shërbimeve Mediale gjatë Fushatës Zgjedhore**², e cila synon të siguroj një ambient mediatik të paanshëm dhe transparent gjatë periudhës zgjedhore, duke garantuar një informim të balancuar dhe objektiv për të gjitha subjektet politike të certifikuara. Ajo përcakton detyrimet e ofruesve që të respektojnë standardet e lirisë së shprehjes dhe për të siguruar një përfaqësim të barabartë në emisione, duke rregulluar edhe reklamimet politike me kufizime të qarta kohore dhe përmbajtëse. Gjithashtu, rregullorja parashikon mekanizma monitorimi dhe masa disiplinore për shkelje nga ana e KPM-së, me qëllim të ruajtjes së integritetit të procesit zgjedhor.

Për më tepër, kjo rregullore ka përcaktuar se hapësira që transmetuesit mund të ua shesin të gjitha subjekteve politike për reklamim është 6 orë brenda periudhës që fillon prej orës 12:00 deri në orën 24:00. Këtë hapësirë, transmetuesit duhet të ua ofrojnë në mënyrë të barabartë të gjitha subjekteve të certifikuara.

Ndërsa kufiri sasior i kohës së emetimit politik për një subjekt politik të certifikuar brenda një dite është 90 minuta.

Rregullorja gjithashtu i ka obliguar të gjithë ofruesit e shërbimeve mediale (OSHM) që të mbajnë ditarë të veçantë ditor për qasjet e siguruara pa pagesë dhe kohët për reklamim që i janë shitur çdo subjekti politik të certifikuar. Këta ditarë, sipas rregullores, duhet të dorëzohen ditën e hënë për të raportuar për javën para-prake, ndërsa KPM do të shqiptoj masa sanksionuese ndaj OShM-ve që nuk i dorëzojnë ditarët.

1 Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2012.

2 Komisioni i Pavarur i Mediave, Rregulloren 2024/03 për Obligimet e Ofruesve të Shërbimeve Mediale gjatë Fushatës Zgjedhore, 16 dhjetor 2024.

Ndërkaq, në **Rregulloren për Komunikimet Komer-
ciale Audio dhe Audiovizuele**³ të miratuar nga KPM
në dhjetor të vitit 2023, ndalohet vendosja e produk-
teve në emisionet politike. Kjo dispozitë synon të ruajë
pavarësinë e përmbajtjes politike dhe të parandalojë
ndikimin e interesave të ndryshme në debatet dhe in-
formacionin e ofruar për publikun.

Në **Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshëm**, të miratuar
në qershor të vitit 2023, është rregulluar çështja e me-
diave gjatë fushatës zgjedhore. Në nenin 48 të këtij ligji
thuhet “të gjitha mediat sigurojnë se të gjitha subjek-
tet politike të certifikuara përfaqësohen në mënyrë të
drejtë dhe të paanshme në emisionet gjatë fushatës së
zgjedhjeve, dhe të gjitha mediat transmetuese u sig-
urojnë të gjitha subjekteve politike të certifikuara qasje
të drejtë dhe të paanshme në programet me diskutime
politike dhe debate”.

Neni 49 i këtij ligji përcakton rregullat e përgjithshme
për reklamimin politik në radio dhe televizion, duke
kufizuar kohëzgjatjen e pikave reklamuese politike në
maksimum dy (2) minuta (120 sekonda).

Gjithashtu, sipas ligjit, transmetuesit që vendosin të
ofrojnë hapësirë për reklamim politik me pagesë, janë
të detyruar që gjatë periudhës së fushatës të sigurojnë
një sasi minimale minutash për emetim pa pagesë për
secilin subjekt politik të certifikuar, duke garantuar qa-
sje të barabartë.

Për më tepër, neni 52 i këtij ligji ndalon rreptësishtë
transmetimin ose publikimin e çfarëdo materiali të lid-
hur me aktivitetet e fushatës zgjedhore brenda periu-
dhës që fillon 24 orë para hapjes së vendvotimeve dhe
zgjat deri në mbylljen zyrtare të tyre. Këto dispozita
synojnë të ruajnë neutralitetin mediatik dhe të paranda-
lojnë ndikimin e padrejtë mbi votuesit në fazën e fundit
të procesit zgjedhor.

Ky ligj ka sjellë disa ndryshime në krahasim me ligjin e
mëparshëm, që ishte miratuar në qershor të vitit 2008⁴.
Ligji i ri ka paraparë obligimin e KPM-së që përmes
akteve nënligjore të rregulloj edhe publikimet online
gjatë tërë procesit zgjedhor, si dhe e ka forcuar rolin
e KPM-së në monitorimin e mediave gjatë periudhës
zgjedhore.

3 KPM - 2023 - 02 Rregullore për komunikimet komerciale audio dhe audiovizuele.
4 Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/I-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME NGA MONITORIMI

Të dhënat e përgjithshme të monitorimit të mediave
gjatë fushatës zgjedhore përfshijnë kronikat zgjedhore,
respektimi i kuotës gjinore gjatë transmetimit të kro-
nikave zgjedhore, pjesëmarrja e kandidatëve në deba-
tet televizive, livestream-at e portaleve, monitorimi i
rrjeteve sociale të kandidatëve për kryeministër, si dhe
të subjekteve politike.

Rezultatet e paraqitura në vijim synojnë të ofrojnë një
pasqyrë të përgjithshme mbi nivelin e transparencës,
(pa)anshmërinë dhe qasjen në hapësirën mediatike të
subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore të 9 shkur-
tit 2025.


Të dhënat nga monitorimi i 11 televizioneve tregojnë se
gjatë kësaj periudhe ka pasur afër 69 orë kronika zg-
jedhore, mbi 511 orë debate politike, 293 transmetime
direkte në faqet zyrtare të portaleve me mbi 18 mijë

minuta, mbi 16 mijë postime në faqet zyrtare në Face-
book të subjekteve politike dhe 579 postime në faqet
zyrtare të kandidatëve për kryeministër.

Kronikat zgjedhore


Sipas rezultateve të monitorimit, në kronikat zgjedhore
televizive Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka pasur
mbulimin më të gjatë, me 791 minuta, e ndjekur nga
Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me 762 minuta.
Më tej renditen Koalicioni AAK-NISMA-Konservatorët,
Intelektualët (AAK-NISMA) me 722 minuta, Lëvizja
Vetëvendosje me 685 minuta, Koalicioni për Familje
me 281 minuta dhe Lista Serbe (Srpska lista) me 103
minuta. Subjektet e tjera politike janë mbuluar gjithsej
për 173 minuta.

FIGURA 1 Koha në minuta për secilin subjekt dhe koalicion në kronika zgjedhore




Gjatë kronikave zgjedhore, pjesa më e madhe e hapësirës televizive u është dedikuar kandidatëve për kryeministër ose prijësve të listave garuese, të cilët kanë pasur në dispozicion 1123 minuta. Në krahasim, kandidatët e tjerë kanë përfituar vetëm 547 minuta.

FIGURA 2 Krahasimi i kohës ndërmjet kandidatëve për Kryeministër apo prijësve të listave dhe kandidatëve tjerë për deputetë



Ndërkaq nga ana e kandidatëve për kryeministër Lumir Abdixhiku (LDK) kryeson me 300 minuta në kronikat zgjedhore, i pasuar nga Bedri Hamza (PDK) me 286 minuta, Albin Kurti (LVV) me 237 minuta, Ramush Haradinaj (AAK-NISMA) me 179 minuta, Eman Rrahmani (Koalicioni për Familje) me 48 minuta dhe Zlatan Elek (Lista Serbe) me 28 minuta. Në total, kandidatët e subjekteve të tjera janë mbuluar për 45 minuta.


FIGURA 3 Koha në minuta për kandidatët për KM apo prijësve të listave



Renditja e partive politike sipas hapësirës së dhënë në kronikat zgjedhore për kandidatët për deputetë ndryshon nga ajo kandidatëve për kryeministër. Në këtë kontekst, kandidatët e Koalicionit AAK-NISMA-Konservatorët, Intelktualët (AAK-NISMA) kryesojnë me 175 minuta, të ndjekur nga ata të Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) me 83 minuta, Koalicionit për Familje me 82 minuta, Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) me 81 minuta, Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) me 59 minuta, Demokracisë Serbe (Srpska Demokratija) me 32 minuta dhe Listës Serbe (Srpska lista) me 16 minuta. Ndërkohë, kandidatët e subjekteve të tjera kanë pasur në total 19 minuta.

Fakti që AAK-NISMA ka pasur hapësirë më të madhe në kronikat zgjedhore tek kandidatët për deputetë, mund të jetë për shkak të natyrës së tij si koalicion. Kandidatët nga secila parti e koalicionit janë llogaritur veçmas në kronikat zgjedhore, duke rritur kështu minutazhin total të koalicionit, krahasuar me partitë që kanë garuar të vetme.

FIGURA 4 Koha në minuta për kandidatë për deputetë sipas gjinisë



Këto të dhëna sugjerojnë se, pavarësisht angazhimit për barazi gjinore në politikë, gratë kanë pasur një prezencë shumë më të ulët në mbulimin mediatik gjatë fushatës zgjedhore në televizione. Kjo pabarazi mund të ketë ndikim në perceptimin publik dhe në mundësitë e tyre për të arritur sukses në zgjedhje.

Aspekti gjinor gjatë transmetimit të kronikave zgjedhore

Aspekti gjinor në transmetimet e kronikave zgjedhore për Zgjedhjet e vitit 2025 tregon për një pabarazi të theksuar. Nga 27 subjekte politike që kanë garuar, vetëm dy prej tyre kanë pasur gra si prijëse të listave. Po ashtu, numri i kandidateve gra mbetet i ulët, pasi asnjë subjekt politik nuk ka arritur të tejkalojë përfaqësimin prej 37% gra (përqindja më e lartë në këto zgjedhje).

Kjo pabarazi reflektohet edhe në hapësirën televizive të dedikuar grave gjatë fushatës. Nga 1298 kronika që kanë përfshirë kandidatët për deputetë (gra dhe burra), vetëm 207 prej tyre (16%) u janë kushtuar kandidateve gra.

Gjithashtu edhe koha televizive për kandidatet gra ka qenë shumë më e ulët se sa për kandidatët burra. Nga 547 minuta që janë transmetuar kandidatët për deputetë vetëm 71 minuta (13%) kanë qenë për kandidatët gra.

Sa i përket kandidateve gra që kanë pasur minutazhën më të madhe, nga top pesë kandidatet, katër prej tyre janë nga Lëvizja Vetëvendosje. Albulena Haxhiu 14 minuta, Donika Gërvalla 11 minuta, Mimoza Kusari Lila gjashtë minuta, Arbërie Nagavci pesë minuta dhe Time Kadrijaj nga Koalicioni AAK-NISMA me katër minuta.

Debatet televizive

Gjatë periudhës 11 janar – 8 shkurt janë monitoruar 11 televizione në nivel vendi. Gjatë kësaj periudhe janë monitoruar gjithsej 409 debate.

Nga këto debate, dominojnë ato vetëm me një subjekt politik (223 debate), pasuar nga debatet vetëm me analistë (131 debate).

Gjatë kësaj fushate vërehet mungesa e ballafaqimit të subjekteve politike, ku vetëm 47 debate kanë qenë me më shumë se një subjekt (34 debate me shumë subjekte, dhe 13 debate në mes të dy subjekteve).

Kjo tregon një mungesë serioze të debatit të hapur dhe përballjes së drejtpërdrejtë të ideve gjatë kësaj fushate zgjedhore, duke kufizuar mundësinë e qytetarëve për të dëgjuar alternativa dhe argumentime.

Një faktor kyç në këtë mungesë ballafaqimi ka qenë refuzimi i LVV-së për të marrë pjesë në debate në të paktën tre mediume kryesore, si dhe refuzimi i kryeministrit për të debatuar me kandidatët e tjerë.


Ky vendim ka ndikuar drejtpërdrejt në strukturën e debateve dhe pjesëmarrjen e subjekteve të tjera. Në mungesë të LVV-së, formatet e ballafaqimeve politike kanë qenë të kufizuara, duke çuar në një shpërndarje të pabarabartë të pjesëmarrjes në debate mes partive politike.

Në këtë kontekst, refuzimi i LVV-së për të marrë pjesë në debate me kundërshtarët politikë ka ndikuar në zvogëlimin e ballafaqimeve politike. Kjo strategji, e justifikuar nga përfaqësuesit e partisë si “*mungesën e kushteve të barabarta*” për subjektet politike nga ana e platformave mediale, ka rezultuar në një fushatë më të mbyllur nga ana e debatit publik.

Gjatë kësaj periudhe PDK ka marrë pjesë në 98 debate, AAK-NISMA në 97 debate, LDK në 71 debate, LVV në 37 debate, Koalicioni për Familje në 28 debate dhe subjektet tjera 47 debate.

Kjo renditje e pjesëmarrjes së subjekteve politike në debate është në masë të madhe rezultat i mungesës së LVV-së në një numër të konsiderueshëm debatesh.


FIGURA 5 Pjesëmarrja në debate televizive sipas subjekteve politike



Sa i përket pjesëmarrjes në debate nga kandidatët e subjekteve politike, janë regjistruar gjithsej: 118 paraqitje nga PDK, 113 nga AAK-NISMA, 92 nga LDK, 38 nga LVV, 38 nga Koalicioni për Familje dhe 51 nga

subjektet tjera. Vlen të theksohet se këto shifra nuk përfaqësojnë kandidatë unikë, pasi disa prej tyre mund të jenë shfaqur në debate më shumë se një herë.


FIGURA 6 Pjesëmarrja e kandidatëve në debate sipas subjekteve politike



Edhe në debate televizive pjesëmarrja e kandidatëve gra është shumë më e ulët se ajo e burrave. 79% e kan-

didatëve në debate kanë qenë burra, ndërsa vetëm 21% gra.

FIGURA 7 Pjesëmarrja në debate e kandidatëve për deputetë sipas gjinisë





Sa i përket pjesëmarrjes së kandidatëve në debate televizive, kandidati për kryeministër nga AAK-NISMA, Ramush Haradinaj ka pasur më së shumti paraqitje, duke marrë pjesë në dhjetë debate televizive.

AAK-NISMA:



Ramush Haradinaj

ka pasur më së shumti paraqitje (**10**).



Arton Demhasaj

(9 paraqitje).



Haki Abazi

(8 paraqitje).



Fatmir Limaj

(7 paraqitje).



Besnik Tahiri dhe Xhevahire Izmaku

(6 paraqitje secili).

LVV:



Armend Muja dhe Nezir Kraki

k4 paraqitje secili).



Daulina Osmani dhe Dimal Basha

(3 paraqitje secili).



Albulena Haxhiu, Fatmire Mulhaxha Kollçaku, Faton Peci, Imri Demelezi

(2 paraqitje secili).

LDK:



Jehona Lushaku Sadriu

(8 paraqitje).



Besian Mustafa dhe Visar Azemi

(6 paraqitje secili).



Lumir Abdixhiku

(5 paraqitje).



Alban Zogaj, Anton Quni, Arben Gashi, Doarsa Kica Xhelili, Hykmete Bajrami, Paris Guri

(4 paraqitje secili).

PDK:



Bedri Hamza

(9 paraqitje).



Arben Mustafa

(8 paraqitje).



Bernard Nikaj, Besa Kabashi Ramaj, Besianë Musmurati, Enver Hoxhaj

(6 paraqitje secili).

TRANSMETIMET E DREJTPËRDREJTA NGA PORTALET


Gjatë fushatës zgjedhore janë monitoruar 15 faqe zyrtare të portaleve në Facebook (*Albanian Post, Ekonomia Online, Gazeta Blic, Gazeta Express, Indeksonline, Insajderi, Kanal 10, Koha.net, Kosova Press, Nacionale, Paparaci, Periskopi, Sinjali, RTV Kim, TV Most*).

Këto portale kanë transmetuar 305 orë e 4 minuta në faqet e tyre zyrtare. Prej kësaj hapësire, AAK-NISMA ka

pasur 205 orë e 53 minuta, LDK 55 orë e 22 minuta, PDK 37 orë e 44 minuta, LVV 5 orë e 58 minuta, dhe subjektet tjera 7 minuta.

Vlen të theksohet se nga këto transmetime, në shumicën e rasteve portalet nuk e kanë cekur nëse këto transmetime janë sponsorizuar nga subjektet politike.

FIGURA 8 Kohëzgjatja në minuta e transmetimeve direkte në faqe të portaleve në Facebook




Monitorimi i faqeve zyrtare të Facebook-ut të kandidatëve për kryeministër

Nga 11 janari deri më 8 shkurt kandidatët për kryeministër nga katër subjektet e mëdha kanë postuar në faqet e tyre zyrtare në Facebook, 579 postime. Lumir

Abdixhiku (LDK) ka pasur 188 postime, Albin Kurti (LVV) 156 postime, Bedri Hamza (PDK) 132 postime dhe Ramush Haradinaj (AAK-NISMA) 103 postime.

FIGURA 9 Postimet e kandidatëve për kryeministër në faqet zyrtare




Monitorimi i faqeve zyrtare të Facebook-ut të subjekteve politike

Nga 11 janari deri më 8 shkurt, katër partitë e mëdha kanë postuar në faqet e tyre, 1615 postime. LVV ka pa-

sur 403 postime, LDK 341 postime, PDK 249 postime dhe AAK-NISMA 110 postime, Koalicioni për Familjen 98 postime, ndërsa subjektet tjera nga minoritetet kanë pasur 414 postime.

FIGURA 10 Postime në Facebook nga faqet zyrtare të subjekteve politike



GJETJET INDIVIDUALE NGA MONIOTRIMI I TELEVISIONE

RADIO TELEVISIONI I KOSOVËS

Radio Televizioni i Kosovës gjatë 29 ditëve të fushatës elektorale ka pasur mbi 11 orë kronika zgjedhore dedikuar aktiviteteve të subjekteve politike dhe afër 47 orë debate televizive.

Kronika zgjedhore

Hapësira për subjekte politike në kronika zgjedhore, në Radio Televizionin e Kosovës, ishte përafërsisht e njëjtë për të gjitha subjektet e mëdha.

LDK dhe PDK kanë marrë më së shumti mbulim, me 58 kronika si për subjektin politik ashtu edhe për kandidatin për kryeministër.

LVV ka pasur **57** kronika për subjektin politik dhe 50 për kandidatin për kryeministër.

AAK-NISMA është pasuar me 55 kronika për subjektin politik dhe 44 për kandidatin për kryeministër.

Koalicioni për Familje ka marrë 33 kronika për subjektin politik dhe 22 për kandidatin për kryeministër.

Kandidati i pavarur Fatmir Bytyqi ka marrë vetëm 2 kronika.

Paraqitja e kandidatëve për deputetë sipas gjinisë



Të dhënat mbi paraqitjen e kandidatëve për deputetë në kronikat zgjedhore të RTK-së sipas gjinisë tregojnë një pabarazi të ndjeshme në mes të kandidatëve burra dhe gra. Në të gjitha subjektet politike të analizuara, numri i kandidatëve burra të përmendur është dukshëm më i lartë se ai i grave.

- Koalicioni për Familje** nuk ka pasur asnjë kandidatë grua të përmendur në kronikat zgjedhore, ndërsa 52 kandidatë burra janë përmendur.
- AAK-NISMA** ka numrin më të lartë të kandidatëve të përmendur, me 90 burra dhe vetëm 8 gra.
- Lëvizja Vetëvendosje (LVV)** ka një përfaqësim më të balancuar krahasuar me subjektet e tjera, me 39 kandidatë burra dhe 27 kandidatë gra.
- Partia Demokratike e Kosovës (PDK)** ka pasur një përmendje të ulët të grave, me vetëm 2 kandidatë gra, krahasuar me 28 kandidatë burra.
- Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)** ka pasur 7 gra dhe 29 burra të përmendur në kronikat zgjedhore.

Sa i përket hapësirës televizive në minuta në RTK, prin LDK me 156 minuta, pasuar nga PDK me 154 minuta, AAK-NISMA me 150 minuta, LVV me 149 minuta, Koali-

cioni për Familje me 70 minuta dhe kandidati i pavarur Fatmir Bytyqi me 3 minuta.


FIGURA 11 Kohëzgjatja në minuta e kronikave zgjedhore në RTK sipas subjekteve politike



Kandidati për kryeministër nga LDK, Lumir Abdixhiku është kandidati me minutazhën më të gjatë në RTK me gjithsej 75 minuta, ndjekur nga kandidati i PDK-së, Bedri Hamza me 74 minuta, Albin Kurti nga LVV me 61 minuta, Ramush Haradinaj nga AAK-NISMA me 41 minuta dhe Eman Rrahmani nga Koalicioni për Familje me 29 minuta. Përdërisa kandidatët për kryeministër kanë pasur 263 minuta hapësirë në kronikat zgjedhore, kandidatët

e tjerë për deputetë kanë pasur vetëm 136 minuta. Edhe në aspektin e kohëzgjatjes së paraqitjeve të kandidateve gra vërehet që u është dhënë shumë më pak hapësirë në raport me kandidatët burra. Nga 136 minuta që janë paraqitur kandidatët për deputetë, kandidatet gra janë paraqitur vetëm 27 minuta (19%), ndërsa kandidatët burra janë paraqitur me 110 minuta (81%).

FIGURA 12 Krahasoni i hapësirës në minuta në kronikat zgjedhore në RTK



Krahasoni i hapësirës në minuta në kronikat zgjedhore në RTK

Debatet televizive

RTK përgjatë periudhës 11 janar - 8 shkurt, ka realizuar 31 debate televizive. Prej tyre 12 debate kanë qenë për prezantimin e një subjekti/kandidati, 12 debate kanë qenë vetëm me analistë dhe 7 debate kanë qenë me shumë subjekte/kandidatë. Nga debatet me subjektet politike në shtatë raste është prezantuar programi i partisë, ndërsa në 12 raste tjera është diskutuar për pjesërisht për programin e partisë.


Në debatet televizive të RTK-së, AAK-NISMA kanë marrë pjesë në dhjetë debate, PDK në nëntë debate, LVV në gjashtë debate Koalicioni për Familje në dy debate, Partia Balli Kombëtar Demokrat Shqiptar, Fjala dhe

Kandidati i pavarur Fatmir Bytyqi nga një debat. Lidhja Demokratike e Kosovës ka refuzuar të marrë pjesë në debatet e mbajtura në RTK.

Në debatet televizive kanë marrë pjesë gjithsej 35 kandidatë për deputetë, ku pjesëmarrja më e madhe ka qenë nga kandidatët e Koalicionit AAK-NISMA me 12 pjesëmarrës, pasuar nga PDK me 11, LVV me gjashtë, Koalicioni për Familje me tre, dhe tri subjektet tjera me nga një kandidatë pjesëmarrës.

Nga 35 kandidatët pjesëmarrës 29 kanë qenë burra (83%) dhe gjashtë gra (17%).

FIGURA 13 Pjesëmarrja e kandidatëve për deputetë në debatet televizive të RTK-së sipas gjinisë



Pjesë e debateve televizive në RTK kanë qenë gjashtë analistë, ku prej tyre dy kanë qenë gra. Së bashku kanë pasur 81 paraqitje, ku analistet gra kanë pasur 28 paraqitje, ndërsa analistët burra 53 paraqitje.

Diskutimi në debatet në RTK është fokusuar në ofertat nga programet politike të secilës parti për temën përkatëse. Moderatorët e emisionit kanë theksuar para çdo emisioni edhe ftesat për subjektet të cilat nuk kanë marrë pjesë.

Moderatorët kanë qenë korrekt ku të gjithë pjesëmarrësit kanë pasur pothuajse hapësirë të barabartë.

Debatet janë zhvilluar në një atmosferë të qetë, me shumë pak ndërhyrje dhe me një gjuhë të moderuar. Përfundim bën debati me Visar Korenicën nga Koalicioni për Familje, i cili ka lëshuar emisionin për shkak që RTK ka ndalur transmetimin e një spoti të këtij subjekti për shkak që kanë konsideruar që shkel rregullat zgjedhore.

KOHAVISION

Kohavision gjatë 29 ditëve të fushatës elektorale ka pasur mbi tetë orë kronika zgjedhore dedikuar aktiviteteve të subjekteve politike dhe mbi 44 orë debate televizive.

Kronika zgjedhore

Hapësira për subjekte politike në kronikat zgjedhore të KTV-së ishte e ngjashme për partitë kryesore, me disa dallime në mbulimin e kandidatëve për kryeministër.

PDK ka marrë mbulimin më të madh me 54 kronika për subjektin politik dhe 52 për kandidatin për kryeministër. **LDK** është pasuar me 51 kronika për subjektin politik dhe 48 për kandidatin për kryeministër. **AAK-NISMA** ka pasur 53 kronika për subjektin politik dhe 45 për kandidatin për kryeministër. **LVV** ka marrë 47 kronika për subjektin politik dhe 37 për kandidatin për kryeministër. **Koalicioni për Familje** ka marrë 5 kronika për subjektin politik dhe 2 për liderin e subjektit. **IRDK** ka pasur mbulimin më të ulët, me vetëm 3 kronika si për subjektin politik ashtu edhe për liderin e subjektit.

Paraqitja e kandidatëve për deputetë sipas gjinisë




Në kronikat zgjedhore të KTV-së, numri i kandidatëve për deputetë të përmendur sipas gjinisë tregon një pabarazi të dukshme mes burrave dhe grave.

- **AAK-NISMA** ka marrë mbulimin më të madh për kandidatët burra, me 75 përmendje, ndërsa për gratë ka pasur vetëm 7 përmendje.
- **PDK** ka pasur 26 përmendje për kandidatët burra dhe asnjë për kandidate gra.
- **LVV** ka pasur një shpërndarje më të balancuar krahasuar me subjektet tjera, me 21 përmendje për gratë dhe 18 për burrat.
- **LDK** ka pasur 24 përmendje për kandidatët burra dhe vetëm 2 për kandidate gra.

Sa i përket hapësirës televizive në minuta, prin PDK me 123 minuta, pasuar nga AAK-NISMA me 122 minuta, LDK me 119 minuta, LVV me 106 minuta, Koalicioni për Familje me tetë minuta dhe IRDK me katër minuta.

FIGURA 14 Kohëzgjatja në minuta e kronikave zgjedhore në KTV sipas subjekteve politike




Kandidati për kryeministër nga PDK, Bedri Hamza është kandidati me minutazhën më të gjatë në KTV me gjithsej 45 minuta, ndjekur nga kandidati i LDK-së, Lumir Abdixhiku me 40 minuta, Albin Kurti nga LVV me 32 minuta, Ramush Haradinaj nga AAK-NISMA me 25 minuta dhe Eman Rrahmani nga Koalicioni për Familje me 1 minut.

Përderisa kandidatët për kryeministër kanë pasur 143 minuta hapësirë në kronikat zgjedhore, kandidatët e

tjerë për deputetë kanë pasur vetëm 67 minuta. Edhe në aspektin e kohëzgjatjes së paraqitjeve të kandidatëve gra vërehet që u është dhënë shumë më pak hapësirë në raport me kandidatët burra.

Nga 67 minuta që janë paraqitur kandidatët për deputetë, kandidatet gra janë paraqitur vetëm tetë minuta (12%), ndërsa kandidatët burra janë paraqitur me 59 minuta (88%).

FIGURA 15 Krahasoni i hapësirës në minuta në kronikat zgjedhore në KTV



Debatet televizive


KTV përgjatë periudhës 11 janar-8 shkurt, ka realizuar 39 debate televizive. Prej tyre 19 debate kanë qenë vetëm me analistë, 11 debate kanë qenë me shumë subjekte/kandidatë, pesë kanë qenë për prezantimin e një subjekti/kandidati dhe katër debate kanë qenë në mes dy subjekteve/kandidatëve. Nga debatet me subjektet politike në asnjë rast nuk është prezantuar në tërësi programi i partisë, duke u diskutuar pjesërisht për pika të caktuara të programit.

Në debatet televizive të KTV-së, AAK-NISMA kanë marrë pjesë në 18 debate, LVV në dhjetë debate, PDK në nëntë debate, LDK në katër debate, Koalicioni për Familje në tre debate, Partia Liberale Egjiptiane në dy

debate, Partia Rome e Bashkuar e Kosovës, Partia Balli Kombëtar Demokrat Shqiptar, Partia e Re Demokratike (Nova Demokratska Stranka) dhe Partia e Serbëve të Kosovës (Partija kosovskih Srba) në nga një debat. Në debatet televizive kanë marrë pjesë gjithsej 50 kandidatë për deputetë, ku pjesëmarrja më e madhe ka qenë nga kandidatët e Koalicionit AAK-NISMA me 18 pjesëmarrës, pasuar nga LVV me 10, PDK me nëntë, LDK me 4, Koalicioni për Familje me 3, Partia Liberale Egjiptiane me 2, dhe katër subjektet tjera me nga një kandidatë pjesëmarrës.

Nga 50 kandidatët pjesëmarrës 37 kanë qenë burra (74%) dhe 13 gra (26%).

FIGURA 16 Pjesëmarrja e kandidatëve për deputetë në debatet televizive të KTV-së sipas gjinisë



Pjesë e debateve televizive në KTV kanë qenë 51 analistë me 64 paraqitje në total. Nga 51 analistë, 44 prej tyre kanë qenë burra (56 paraqitje), ndërsa shtatë gra (7 paraqitje).

Në përgjithësi, debatet politike në KTV janë zhvilluar me një atmosferë korrekte dhe profesionale. Debatet qenë

gjithëpërfshirëse, duke përfshirë edhe përfaqësues të partive minoritare. Gjuha e përdorur ka qenë korrekte, dhe të gjithë pjesëmarrësit kanë pasur pothuajse hapësirë të barabartë, pasi pyetjet kanë qenë të njëjta për të gjithë.

KLAN KOSOVA

Klan Kosova gjatë 29 ditëve të fushatës elektorale ka pasur mbi 9 orë kronika zgjedhore dedikuar aktiviteteve të subjekteve politike dhe mbi 62 orë debate televizive.

Gjatë monitorimit të raportimeve mediatike, është vërejtur një qasje e njëanshme nga ana e Klan Kosovës ndaj LVV-së. Konkretisht, shumica e kronikave zgjedhore dhe e debateve politike e kanë paraqitur këtë subjekt politik nga një këndvështrim kryesisht negativ, antagonist dhe kritikues. Po ashtu, ka pasur një mungesë të ekuilibrit në ofrimin e hapësirës për sqarime ose për mbrojtjen e pikëpamjeve të LVV-së, duke krijuar kështu një perceptim të pabarazisë në trajtimin mediatik të partive politike.

Kronika zgjedhore

Në kronikat zgjedhore të Klan Kosovës, mbulimi i subjekteve politike dhe kandidatëve për kryeministër ka qenë i balancuar për partitë kryesore, ndërsa subjektet më të vogla kanë pasur një prani minimale.

- PDK** ka marrë mbulimin më të madh me 48 kronika për subjektin politik dhe 48 për kandidatin për kryeministër.
- LDK** ka pasur 45 kronika si për subjektin politik ashtu edhe për kandidatin për kryeministër.
- AAK-NISMA** ka pasur 45 kronika për subjektin politik dhe 44 për kandidatin për kryeministër.
- LVV** ka marrë 42 kronika për subjektin politik dhe po aq për kandidatin për kryeministër.
- Koalicioni për Familje** ka pasur 23 kronika për subjektin politik dhe 23 për liderin e subjektit.
- Partia Liberale Egjiptiane** ka marrë vetëm 1 kronikë për subjektin politik dhe 1 për liderin e subjektit.
- PDAK-LPB** ka pasur 1 kronikë për subjektin politik dhe asnjë për liderin e subjektit.

Paraqitja e kandidatëve për deputetë sipas gjinisë




Në kronikat zgjedhore të Klan Kosovës, numri i kandidatëve për deputetë të përmendur sipas gjinisë tregon një pabarazi të theksuar, ku kandidatët burra janë përmendur shumë më shpesh se gratë.

- AAK-NISMA** ka marrë mbulimin më të madh për kandidatët burra, me 73 përmendje, ndërsa për gratë ka pasur vetëm 9 përmendje.
- LDK** ka pasur 35 përmendje për kandidatët burra dhe 3 për candidate gra.
- LVV** ka pasur 18 përmendje për kandidatët burra dhe 20 për candidate gra, duke treguar një shpërndarje më të barabartë krahasuar me subjektet e tjera.
- PDK** ka pasur 21 përmendje për kandidatët burra dhe 2 për candidate gra.
- Koalicioni për Familje** ka pasur vetëm 23 përmendje për kandidatët burra dhe asnjë për candidate gra.


- Partia Liberale Egjiptiane** ka pasur 1 përmendje për kandidatët burra dhe 1 për candidate gra.
 - PDAK-LPB** ka pasur 1 përmendje për kandidatët burra dhe asnjë për candidate gra.
- Sa i përket hapësirës televizive në minuta, prin LDK me 137 minuta, pasuar nga PDK me 130 minuta, AAK-NISMA me 119 minuta, LVV me 110 minuta, Koalicioni për Familje me 54 minuta, Partia Liberale Egjiptiane me tre minuta dhe PDAK-LPB me dy minuta.

FIGURA 17 Kohëzgjatja në minuta e kronikave zgjedhore në Klan Kosova sipas subjekteve politike



Kandidati për kryeministër nga LDK, Lumir Abdixhiku është kandidati me minutazhën më të gjatë në Klan Kosova me gjithsej 36 minuta, ndjekur nga kandidati i PDK-së, Bedri Hamza me 34 minuta, Albin Kurti nga LVV me 18 minuta, Ramush Haradinaj nga AAK-NISMA me 15 minuta dhe Eman Rrahmani nga Koalicioni për Familje me pesë minuta. Përderisa kandidatët për kryeministër kanë pasur 98 minuta hapësirë në kronikat zgjedhore, kandidatët e tjerë për deputetë kanë pasur vetëm 47 minuta. Edhe në aspektin e kohëzgjatjes së paraqitjeve të candidateve gra vërehet që u është dhënë shumë më pak hapësirë në raport me kandidatët burra. Nga 47 minuta që janë paraqitur kandidatët për deputetë, kandidatet gra janë paraqitur vetëm gjashtë minuta (13%), ndërsa kandidatët burra janë paraqitur me 41 minuta (87%).

FIGURA 18 Krahasimi i hapësirës në minuta në kronikat zgjedhore në KlanKosova



Krahasimi i hapësirës në minuta në kronikat zgjedhore në KlanKosova

Debatet televizive

Klan Kosova përgjatë periudhës 11 janar-8 shkurt, ka realizuar 47 debate televizive. Prej tyre 27 debate prezantimin e një subjekti/kandidati, 11 kanë qenë vetëm me analistë, shtatë kanë qenë emisione argëtuese ku janë realizuar intervista me anëtarë të subjekteve politike dhe 4 debate me shumë subjekte/kandidatë. Nga debatet me subjektet politike në pesë raste është prezantuar programi i partisë, ndërsa në 30 raste tjera është diskutuar pjesërisht për programin.


Në debatet televizive të Klan Kosovës, PDK kanë marrë pjesë në 15 debate, LDK dhe AAK-NISMA në 12 debate

dhe Koalicioni për Familje në katër debate. Lëvizja Vetëvendosje ka refuzuar të marrë pjesë në debatet që janë realizuar në këtë televizion.

Në debatet televizive kanë marrë pjesë gjithsej 52 kandidatë për deputetë, ku pjesëmarrja më e madhe ka qenë nga kandidatët e PDK-së me 20 pjesëmarrës, pasuar nga AAK-NISMA me 15, LDK me 13, dhe Koalicioni për Familje me katër.

Nga 52 kandidatët pjesëmarrës, 41 kanë qenë burra (79%) dhe 11 gra (21%).

FIGURA 19 Pjesëmarrja e kandidatëve për deputetë në debatet televizive të Klan Kosova sipas gjinisë



Pjesë e debateve televizive në Klan Kosova kanë qenë 16 analistë me 101 paraqitje në total. Nga 16 analistë, 13 prej tyre kanë qenë burra (84 paraqitje), ndërsa tri gra (17 paraqitje).

Debatet në Klan Kosova kryesisht kanë qenë të qeta, ndonëse kanë qenë të anshme dhe në disa raste analistët kanë pasur tendencë të nxitjes së gjuhës së urrejtjes dhe duke përdorur disa terme jo adekuate gjatë bashkëbisedimit. Për këtë, moderatori nuk ka pasur vërejtje gjatë mbarëvajtjes së emisionit.

Në disa debate është vënë re mungesa e një analize të thelluar mbi programet politike të subjekteve, duke i

lënë më shumë hapësirë diskutimit mbi atë çfarë kanë paraparë oponentët politik dhe atë që është bërë në qeverisjen e fundit, sesa diskutimit mbi çështje konkrete që prekin qytetarët mbi programet e tyre. Pra, shpesh herë ka ndodhur që orientimi i debatit nuk ka qenë korrekt, pra nuk është orientuar debati në çështjen për të cilën janë ftuar subjektet politike.

Në 28 emisione debutuese gjatë fushatës zgjedhore në Klan Kosova ka pasur vendosje të produkteve apo reklamim para fillimit të emisionit. Siç është shtjelluar edhe në pjesën e Kornizës Ligjore të këtij raporti, në Rregulloren për Komunikimet Komeriale Audio dhe Audiovizuale ndalohet vendosja e produkteve në emisionet politike.

RADIO TELEVISIONI 21 (RTV 21)

RTV 21 gjatë 29 ditëve të fushatës elektorale ka pasur mbi 7 orë kronika zgjedhore dedikuar aktiviteteve të subjekteve politike dhe mbi 45 orë debate televizive.

Kronika zgjedhore

Në kronikat zgjedhore të RTV 21, mbulimi i subjekteve politike dhe kandidatëve për kryeministër ka qenë i shpërndarë në mënyrë të ndryshme mes partive kryesore dhe subjekteve më të vogla.

LDK ka marrë mbulimin më të madh me 51 kronika për subjektin politik dhe 43 për kandidatin për kryeministër. **PDK** ka pasur 47 kronika për subjektin politik dhe 45 për kandidatin për kryeministër. **AAK-NISMA** ka marrë 36 kronika për subjektin politik dhe 31 për kandidatin për kryeministër. **LVV** ka pasur 32 kronika për subjektin politik dhe 28 për kandidatin për kryeministër. **Koalicioni për Familje** ka marrë 22 kronika për subjektin politik dhe 15 për liderin e subjektit. **Lista Serbe** ka pasur 2 kronika për subjektin politik dhe 1 për liderin e subjektit. **Partia Liberale Egjiptiane** ka pasur 2 kronika për subjektin politik dhe 2 për liderin e subjektit. **Partia e Ashkalinjëve për Integrim** ka pasur 2 kronika për subjektin politik dhe 2 për liderin e subjektit.

Paraqitja e kandidatëve për deputetë sipas gjinisë




Në kronikat zgjedhore të RTV 21, numri i kandidatëve për deputetë të përmendur sipas gjinisë tregon një dominim të theksuar të kandidatëve burra ndaj grave.

- **AAK-NISMA** ka marrë mbulimin më të madh për kandidatët burra, me 35 përmendje, ndërsa për gratë ka pasur vetëm 8 përmendje.
- **LDK** ka pasur 26 përmendje për kandidatët burra dhe 2 për kandidate gra.
- **Koalicioni për Familje** ka pasur 27 përmendje për kandidatët burra dhe asnjë për kandidate gra.
- **LVV** ka pasur 10 përmendje për kandidatët burra dhe 9 për kandidate gra, duke pasur një shpërndarje më të barabartë krahasuar me subjektet e tjera.
- **PDK** ka pasur 4 përmendje për kandidatët burra dhe asnjë për kandidate gra.

Sa i përket hapësirës televizive në minuta, prin LDK me 118 minuta, pasuar nga PDK me 109 minuta, AAK-NISMA me 85 minuta, LVV me 73 minuta, Koalicioni për Familje me 54 minuta, Partia Liberale Egjiptiane me 5 minuta, Partia e Ashkalinjëve për Integrim me 5 minuta dhe Lista Serbe me 4 minuta.


FIGURA 20 Kohëzgjatja në minuta e kronikave zgjedhore në RTV 21 sipas subjekteve politike



Kandidati për kryeministër nga PDK, Bedri Hamza është kandidati me minutazhën më të gjatë në RTV 21 me gjithsej 63 minuta, ndjekur nga kandidati i LDK-së, Lumir Abdixhiku me 58 minuta, Albin Kurti nga LVV me 40 minuta, Ramush Haradinaj nga AAK-NISMA me 38 minuta dhe Eman Rrahmani nga Koalicioni për Familje me 13 minuta.

Përderisa kandidatët për kryeministër kanë pasur 211 minuta hapësirë në kronikat zgjedhore, kandidatët e tjerë për deputetë kanë pasur vetëm 88 minuta. Edhe në aspektin e kohëzgjatjes së paraqitjeve të kandidatëve gra vërehet që u është dhënë shumë më pak hapësirë në raport me kandidatët burra. Nga 88 minuta që janë paraqitur kandidatët për deputetë, kandidatet gra janë paraqitur vetëm 9 minuta (10%), ndërsa kandidatët burra janë paraqitur me 79 minuta (90%).

FIGURA 21 Krahاسimi i hapësirës në minuta në kronikat zgjedhore në RTV 21



Debatet televizive

RTV 21 përgjatë periudhës 11 janar-8 shkurt, ka realizuar 36 debate televizive. Prej tyre 33 debate kanë qenë për prezantimin e një subjekti/kandidati dhe tri debate vetëm me analistë. Nga debatet me subjektet politike në 16 raste është prezantuar programi i partisë, ndërsa në 14 raste tjera është diskutuar pjesërisht për programin.


Në debatet televizive të RTV 21, AAK-NISMA kanë marrë pjesë në gjashtë debate, LDK dhe PDK në nga pesë debate, LVV në tri debate, Koalicioni për Familje në dy debate, Partia e Lëvizjes Inovative Turke (Yenilikçi Türk Hareket Partisi) në dy debate, Fjala, IRDK - Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës, Partia Rome e Bashkuar e Kosovës, Partia Liberale Egjiptiane, Partia Balli Kombëtar Demokrat Shqiptar, Partia e Re Demokratike (Nova Demokratska Stranka), Partia e Ashkalinjëve për Integrim, PDAK-LPB, Koalicioni Vakaf (Koalicija Vakaf) dhe Kandidati i Pavarur Fatmir Bytyqi në nga një debat.

Në debatet televizive kanë marrë pjesë gjithsej 45 kandidatë për deputetë, ku pjesëmarrja më e madhe ka qenë nga kandidatët e PDK-së dhe Koalicionit AAK-NISMA me nga nëntë deputetë, LDK me tetë, Koalicioni për Familje me katër, LVV me tre, Partia e Lëvizjes Inovative Turke (Yenilikçi Türk Hareket Partisi) me dy, dhe subjektet tjera me nga një.

Nga 45 kandidatët pjesëmarrës, 37 kanë qenë burra (82%) dhe 8 gra (18%).

Debatet janë zhvilluar në një atmosferë të qetë, pa ndërhyrje dhe me një gjuhë të moderuar. Përrashtim bën debati me pjesëmarrjen e kandidatëve nga Koalicioni Familja, i cili u sanksionua nga PZAP për përdorimin e gjuhës së urrejtjes. Megjithatë, më pas, Gjykata Supreme e konsideroi këtë brenda kufijve të lirisë së shprehjes.

FIGURA 22 Pjesëmarrja e kandidatëve për deputetë në debatet televizive të RTV 21 sipas gjinisë



Pjesë e debateve televizive në RTV 21 kanë qenë gjashtë analistë me nëntë paraqitje në total. Nga gjashtë anal-

istë, pesë prej tyre kanë qenë burra (7 paraqitje), ndërsa një ka qenë grua (2 paraqitje).

RTV DUKAGJINI

Radio Televizioni Dukagjini gjatë 29 ditëve të fushatës elektorale ka pasur mbi tri orë kronika zgjedhore dedikuar aktiviteteve të subjekteve politike dhe mbi 58 orë debate televizive.

Kronika zgjedhore

Në kronikat zgjedhore të RTV Dukagjini, mbulimi i subjekteve politike dhe kandidatëve për kryeministër ka qenë i ndryshëm, duke reflektuar një dominim të partive kryesore, ndërsa subjektet më të vogla kanë pasur një prani të kufizuar.

- PDK** ka marrë mbulimin më të madh me 30 kronika për subjektin politik dhe 27 për kandidatin për kryeministër.
- LDK** ka pasur 28 kronika për subjektin politik dhe 27 për kandidatin për kryeministër.
- LVV** ka marrë 28 kronika për subjektin politik dhe 23 për kandidatin për kryeministër.
- AAK-NISMA** ka pasur 26 kronika për subjektin politik dhe 20 për kandidatin për kryeministër.
- Koalicioni për Familje** ka marrë 17 kronika për subjektin politik dhe 9 për liderin e subjektit.
- IRDK - Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës** ka pasur 6 kronika për subjektin politik dhe asnjë për liderin e subjektit.
- Partia Rome e Bashkuar e Kosovës** ka pasur 7 kronika për subjektin politik dhe asnjë për liderin e subjektit.
- Partia Liberale Egjiptiane dhe PDAK-LPB** kanë marrë nga 5 kronika për subjektin politik dhe asnjë për liderin e subjektit.
- Partia e Ashkalinjëve për Integrim** ka pasur 3 kronika për subjektin politik dhe asnjë për liderin e subjektit.
- Naša Bošnjačka Koalicija** ka pasur 2 kronika për subjektin politik dhe asnjë për liderin e subjektit.
- Yenilikçi Türk Hareket Partisi** ka marrë 4 kronika për subjektin politik dhe asnjë për liderin e subjektit.

Subjektet e tjera, si Opre Roma Kosova, Koalicija Vakati, Kosova Demokratik Türk Partisi, Srpska Demokratija, Srpska Lista, Partia kosovskih Srba dhe Socialdemokratska Unija - SDU, kanë marrë nga 1 deri në 2 kronika për subjektin politik, por nuk kanë pasur mbulim për liderin e subjektit apo kandidatët tjerë.

Paraqitja e kandidatëve për deputetë sipas gjinisë




Në kronikat zgjedhore të RTV Dukagjini, numri i kandidatëve për deputetë të përmendur sipas gjinisë tregon një dominim të theksuar të kandidatëve burra ndaj grave.

- LVV** ka pasur mbulimin më të madh, me 18 përmendje për kandidatët burra dhe 7 për candidate gra.
- Koalicioni për Familje** ka marrë 11 përmendje për kandidatët burra dhe asnjë për candidate gra.
- AAK-NISMA** ka pasur 10 përmendje për kandidatët burra dhe 2 për candidate gra.
- LDK** ka pasur 7 përmendje për kandidatët burra dhe asnjë për candidate gra.
- PDK** ka pasur 6 përmendje për kandidatët burra dhe asnjë për candidate gra.

- Partia Liberale Egjiptiane** ka pasur 2 përmendje për kandidatët burra dhe asnjë për candidate gra.
- IRDK** ka marrë 1 përmendje për kandidatët burra dhe asnjë për candidate gra.
- PDAK-LPB** ka pasur 1 përmendje për kandidatët burra dhe asnjë për candidate gra.

Sa i përket hapësirës televizive në minuta, prin LDK me 36 minuta, pasuar nga PDK dhe LVV me nga 34 minuta, AAK-NISMA me 31 minuta, Koalicioni për Familje me 19 minuta, dhe 14⁵ subjekte nga minoritetet me 12 minuta së bashku.

FIGURA 23 Kohëzgjatja në minuta e kronikave zgjedhore në RTV Dukagjini sipas subjekteve politike




Kandidati për kryeministër nga LDK, Lumir Abdixhiku është kandidati me minutazhën më të gjatë në RTV Dukagjini me gjithsej 13 minuta, ndjekur nga kandidati i PDK-së, Bedri Hamza me 12 minuta, Albin Kurti nga LVV me 11 minuta, Ramush Haradinaj nga AAK-NISMA me shtatë minuta dhe Eman Rrahmani nga Koalicioni për Familje me katër minuta.

sirë në raport me kandidatët burra. Nga 18 minuta që janë paraqitur kandidatët për deputetë, kandidatet gra janë paraqitur vetëm dy minuta (11%), ndërsa kandidatët burra janë paraqitur me 16 minuta (89%).

Përderisa kandidatët për kryeministër kanë pasur 47 minuta hapësirë në kronikat zgjedhore, kandidatët e tjerë për deputetë kanë pasur vetëm 18 minuta. Edhe në aspektin e kohëzgjatjes së paraqitjeve të kandidatëve gra vërehet që u është dhënë shumë më pak hapë-

5 IRDK - Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës, Srpska Lista, Partia Rome e Bashkuar e Kosovës, Partia Liberale Egjiptiane, Srpska Demokratija, Partia kosovskih Srba, Naša Bošnjačka Koalicija, Partia e Ashkalinjëve për Integrim, PDAK-LPB, Socijaldemokratska Unija – SDU, Yenilikçi Türk Hareket Partisi, Kosova Demokratik Türk Partisi, Koalicija Vakati, Opre Roma Kosova

FIGURA 24 Krahاسimi i hapësirës në minuta në kronikat zgjedhore në RTV Dukagjini



Krahاسimi i hapësirës në minuta në kronikat zgjedhore në RTV Dukagjini

Debatet televizive


RTV Dukagjini përgjatë periudhës 11 janar-8 shkurt, ka realizuar 51 debate televizive. Prej tyre 26 debate kanë qenë vetëm me analistë, 24 emisione për prezantimin e një subjekti/kandidati, dhe një debat i llojit tjetër. Nga debatet me subjektet politike në shtatë raste është prezantuar programi i partisë, ndërsa në pesë raste tjera është diskutuar pjesërisht për programin.

Në debatet televizive të RTV Dukagjini, LDK dhe PDK kanë marrë pjesë në nga nëntë debate secila, AAK-NISMA në katër debate, Koalicioni për Familje në dy debate, Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK) dhe Bashkimi Social Demokrat – SDU (Socijaldemokratska Unija – SDU) në nga një debat. Lëvizja Vetëvendosje ka refuzuar të marrë pjesë në debatet e realizuara nga ky televizion.

Në debatet televizive kanë marrë pjesë gjithsej 33 kandidatë për deputetë, ku pjesëmarrja më e madhe ka qenë nga kandidatët e LDK-së me 13 deputetë pjesëmarrës, PDK me 10, AAK-NISMA me katër, Koalicioni për Familje me katër, IRDK dhe SDU me nga një kandidatët pjesëmarrës.

Nga 32 kandidatët pjesëmarrës, 26 kanë qenë burra (79%) dhe 7 gra (21%).

FIGURA 25 Pjesëmarrja e kandidatëve për deputetë në debatet televizive të RTV Dukagjini sipas gjinisë



Pjesëmarrja e kandidatëve për deputetë në debatet televizive të RTV Dukagjini sipas gjinisë

Pjesë e debateve televizive në RTV Dukagjini kanë qenë 25 analistë me 163 paraqitje në total. Nga 25 analistë, vetëm një prej tyre ka qenë grua ndërsa 24 tjerë burra.

Në debatet e zhvilluara, herë pas here është përdorur gjuhë denigruese, si nga ana e analistëve, ashtu edhe nga pjesëmarrësit politikë. Në veçanti, janë vërejtur komente që mund të perceptohen si stigmatizuese ndaj komuniteteve të caktuara, duke përfshirë deklarata që nxisin tensione dhe polarizim.

Gjithashtu, në disa raste është vënë re përdorimi i një gjuhe fyese dhe denigruese ndaj subjekteve dhe figurave politike, përfshirë komente mbi pamjen fizike dhe etiketime të rënda që shkojnë përtej debatit politik.

Në një rast konkret, një nga pjesëmarrësit është sanksionuar nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parash-tresa për gjuhën e përdorur gjatë debatit.

Për më tepër, janë bërë akuza të drejtpërdrejta dhe etiketime të rënda ndaj partive dhe liderëve të tyre, me theks të veçantë ndaj partisë në pushtet, të cilat kanë ndikuar në uljen e cilësisë së diskutimeve dhe në thellimin e ndasive politike.

Në vend që të fokusohet në një analizë të thelluar të programeve politike dhe çështjeve që prekin qytetarët, shpesh debati ka devijuar drejt sulmeve personale dhe narrativave përçarëse, duke lënë më pak hapësirë për një diskutim konstruktiv dhe të informuar mbi alternativat politike të ofruara.

T7

T7 gjatë 29 ditëve të fushatës elektorale ka pasur afër dy orë kronika zgjedhore dedikuar aktiviteteve të subjekteve politike dhe afër 70 orë debate televizive.

Kronika zgjedhore

Në kronikat zgjedhore të T7, mbulimi i subjekteve politike dhe kandidatëve për kryeministër ka qenë më i përqendruar te partitë kryesore, ndërsa subjektet më të vogla kanë pasur një prani minimale.

LDK ka marrë mbulimin më të madh me 27 kronika për subjektin politik dhe 26 për kandidatin për kryeministër.

PDK ka pasur 26 kronika si për subjektin politik ashtu edhe për kandidatin për kryeministër.

AAK-NISMA ka marrë 25 kronika për subjektin politik dhe 21 për kandidatin për kryeministër.

LVV ka pasur 24 kronika për subjektin politik dhe 20 për kandidatin për kryeministër.

Koalicioni për Familje ka marrë 7 kronika për subjektin politik dhe 4 për liderin e subjektit.

IRDK - Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës ka pasur 3 kronika për subjektin politik dhe asnjë për liderin e subjektit.

Partia Liberale Egjiptiane ka pasur 2 kronika për subjektin politik dhe asnjë për liderin e subjektit.

Yenilikçi Türk Hareket Partisi dhe **Partia Rome e Bashkuar e Kosovës** kanë pasur nga 1 kronikë për subjektin politik dhe asnjë për liderin e subjektit.




Ndërsa kandidatët për deputet janë transmetuar në **28 raste,** ku prej tyre asnjë **nuk është grua.**

Në kronikat zgjedhore të T7, gratë candidate nuk kanë pasur asnjë përmendje.

- **AAK-NISMA** ka marrë mbulimin më të madh për kandidatët burra.
- **PDK** ka pasur 6 përmendje për kandidatët burra.
- **LDK** ka pasur 5 përmendje për kandidatët burra.

6 IRDK - Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës, Partia Rome e Bashkuar e Kosovës, Partia Liberale Egjiptiane, Yenilikçi Türk Hareket Partisi


FIGURA 26 Kohëzgjatja në minuta e kronikave zgjedhore në T7 sipas subjekteve politike



Kandidati për kryeministër nga LVV, Albin Kurti është kandidati me minutazhën më të gjatë në T7 me gjithsej 7 minuta, ndjekur nga kandidatët e PDK-së dhe LDK-së, Bedri Hamza dhe Lumir Abdixhiku me nga 6 minuta, Ramush Haradinaj nga AAK-NISMA me 4 minuta dhe Eman Rrahmani nga Koalicioni për Familje me 2 minuta.

Përderisa kandidatët për kryeministër kanë pasur 25 minuta hapësirë në kronikat zgjedhore, kandidatët e tjerë për deputetë kanë pasur vetëm 8 minuta. Në T7 asnjë candidate grua nuk është paraqitur në kronikat zgjedhore.

FIGURA 27 Krahasoni i hapësirës në minuta në kronikat zgjedhore në T7



Krahasoni i hapësirës në minuta në kronikat zgjedhore në T7

Debatet televizive

T7 përgjatë periudhës 11 janar-8 shkurt, ka realizuar 55 debate televizive. Prej tyre 42 debate kanë qenë emisione për prezantimin e një subjekti/kandidati dhe 13 debate vetëm me analistë. Nga debatet me subjektet politike në tri raste është prezantuar programi i partisë, ndërsa në 21 raste tjera është diskutuar pjesërisht për programin.


Në debatet televizive të T7, PDK ka marrë pjesë në 17 debate, LDK në 15 debate, AAK-NISMA në shtatë debate, Koalicioni për Familje në dy debate, Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK) dhe PDAK-LPB në nga

një debat. Lëvizja Vetëvendosje ka refuzuar të marrë pjesë në debatet e realizuara nga ky televizion.

Në debatet televizive kanë marrë pjesë gjithsej 53 kandidatë për deputetë, ku pjesëmarrja më e madhe ka qenë nga kandidatët e LDK-së me 20 deputetë pjesëmarrës, PDK me 18, AAK-NISMA me nëntë, Koalicioni për Familje me dy, IRDK me dy dhe PDAK-LPB me një kandidatët pjesëmarrës.

Nga 53 kandidatët pjesëmarrës, 40 kanë qenë burra (75%) dhe 13 gra (25%).

FIGURA 28 Pjesëmarrja e kandidatëve për deputetë në debatet televizive të T7 sipas gjinisë



Pjesë e debateve televizive në T7 kanë qenë 37 analistë me 124 paraqitje në total. Nga 37 analistë, 31 prej tyre kanë qenë burra me 112 paraqitje dhe gjashtë gra me 12 paraqitje.

Në debatin Pressing te mbajtur në T7, gjithmonë ka pasur vendosje të produktit.

Gjatë fushatës zgjedhore, televizioni T7 ka organizuar një sërë debatesh politike, ku kanë marrë pjesë si analistë politikë, ashtu edhe përfaqësues të subjekteve politike.

Në debatet e organizuara me pjesëmarrjen ekskluzive të përfaqësuesve të partive politike, diskutimet janë karakterizuar nga një qasje më korrekte dhe më konstruktive.

Përfaqësuesit kanë pasur mundësinë dhe hapësirën e nevojshme për të prezantuar programet e tyre qeverisëse dhe për të shtjelluar platformat politike përballë publikut.

Në anën tjetër, në debatet e organizuara vetëm me analistë politikë, diskursi publik është dominuar kryesisht nga kritikrat ndaj partisë që ka ushtruar pushtetin gjatë katër viteve të fundit. Kjo qasje shpesh ka ndikuar negativisht në cilësinë e diskutimeve, duke e zhvendosur fokusin nga analiza objektive dhe gjithëpërfshirëse në komente subjektive dhe polemika. Në përgjithësi, në këto debate me analistë, vëmendja kryesore i është kushtuar zhvillimeve ditore të fushatës zgjedhore, ndërsa programet dhe platformat e partive politike janë trajtuar në mënyrë sipërfaqësore dhe pa analizë të thelluar.

KANAL 10

Kanal 10 gjatë 29 ditëve të fushatës elektorale ka pasur afër katër orë kronika zgjedhore dedikuar aktiviteteve të subjekteve politike dhe afër 70 orë debate televizive.

Kronika zgjedhore

Në kronikat zgjedhore të Kanal 10, mbulimi i subjekteve politike dhe kandidatëve për kryeministër ka qenë i përqendruar kryesisht te partitë kryesore, ndërsa subjektet më të vogla kanë pasur një prani minimale.

LDK ka marrë mbulimin më të madh me 29 kronika për subjektin politik dhe 28 për kandidatin për kryeministër. **PDK** ka pasur 28 kronika si për subjektin politik ashtu edhe për kandidatin për kryeministër. **AAK-NISMA** ka marrë 27 kronika për subjektin politik dhe 23 për kandidatin për kryeministër. **LVV** ka pasur 25 kronika si për subjektin politik ashtu edhe për kandidatin për kryeministër. **Koalicioni për Familje** ka marrë 6 kronika për subjektin politik dhe 4 për liderin e subjektit. **Partia Liberale Egjiptiane** ka pasur 2 kronika për subjektin politik dhe asnjë për liderin e subjektit.

Paraqitja e kandidatëve për deputetë sipas gjinisë




Në kronikat zgjedhore të Kanal 10, numri i kandidatëve për deputetë të përmendur sipas gjinisë tregon një mbulim të pabarabartë, ku kandidatët burra kanë dominuar dukshëm mbi gratë.

- **AAK-NISMA** ka marrë mbulimin më të madh për kandidatët burra, me 36 përmendje, ndërsa për gratë ka pasur vetëm 4 përmendje.
- **LDK** ka pasur 13 përmendje për kandidatët burra dhe asnjë për kandidate gra.
- **PDK** ka pasur 12 përmendje për kandidatët burra dhe asnjë për kandidate gra.
- **Koalicioni për Familje** ka marrë 7 përmendje për kandidatët burra dhe asnjë për kandidate gra.
- **LVV** ka pasur 8 përmendje për kandidatët burra dhe 4 për kandidate gra.
- **Partia Liberale Egjiptiane** ka pasur 2 përmendje për kandidatët burra dhe asnjë për kandidate gra.


Sa i përket hapësirës televizive në minuta, prin LDK me 54 minuta, pasuar nga PDK me 50 minuta, AAK-NISMA me 49 minuta, LVV me 48 minuta, Koalicioni për Familje me nëntë minuta dhe Partia Liberale Egjiptiane me katër minuta.

FIGURA 29 Kohëzgjatja në minuta e kronikave zgjedhore në Kanal 10 sipas subjekteve politike



Kandidati për kryeministër nga LVV është kandidati me minutazhën më të gjatë në Kanal 10 me gjithsej 22 minuta, ndjekur nga kandidati i LDK-së, Lumir Abdixhiku me 19 minuta, Bedri Hamza nga PDK me 17 minuta, Ramush Haradinaj nga AAK-NISMA me 11 minuta dhe Eman Rrahmani nga Koalicioni për Familje me dy minuta. Përderisa kandidatët për kryeministër kanë pasur 71 minuta hapësirë në kronikat zgjedhore, kandidatët e tjerë për deputetë kanë pasur vetëm 22 minuta. Edhe në aspektin e kohëzgjatjes së paraqitjeve të kandidateve gra vërehet që u është dhënë shumë më pak hapësirë në raport me kandidatët burra. Nga 71 minuta që janë paraqitur kandidatët për deputetë, kandidatet gra janë paraqitur vetëm dy minuta (9%), ndërsa kandidatët burra janë paraqitur me 20 minuta (91%)

FIGURA 30 Krahاسimi i hapësirës në minuta në kronikat zgjedhore në Kanal 10



Debatet televizive


Kanal 10 përgjatë periudhës 11 janar-8 shkurt, ka realizuar 60 debate televizive. Prej tyre 30 kanë qenë emisione për prezantimin e një subjekti/kandidati (shumica e tyre kanë qenë prezantime brenda një emisioni të subjekteve të ndryshme, por pa pasur përballje mes tyre), 27 kanë qenë debate vetëm me analistë, dy debate me shumë subjekte/kandidatë dhe një debat. Nga debatet me subjektet politike në 17 raste është prezantuar programi i partisë dhe në 19 raste tjera është diskutuar pjesërisht për programin e partisë. Në debatet televizive të Kanal 10, LDK kanë marrë pjesë në 14 debate,

AAK-NISMA në 13 debate, PDK në 11 debate, LVV në shtatë dhe Koalicioni për Familje në një debat.

Në debatet televizive kanë marrë pjesë gjithsej 54 kandidatë për deputetë, ku pjesëmarrja më e madhe ka qenë nga kandidatët LDK-së me 18 pjesëmarrës, PDK dhe AAK-NISMA me nga 14 pjesëmarrës, LVV me shtatë dhe Koalicioni për Familje me një pjesëmarrës.

Nga 54 kandidatët pjesëmarrës, 42 kanë qenë burra (78%) dhe 12 gra (22%).

FIGURA 31 Pjesëmarrja e kandidatëve për deputetë në debatet televizive të Kanal 10 sipas gjinisë



Pjesë e debateve televizive në Kanal 10 kanë qenë 20 analistë me 134 paraqitje në total. Nga 20 analistë, 16 prej tyre kanë qenë burra (113 paraqitje), ndërsa katër gra (21 paraqitje).

Debatet zgjedhore në Kanal 10 janë zhvilluar kryesisht të qeta. Moderatorin ka qenë i gatshëm të ndërhyjë në rastet kur situata ka pasur mundësi të tensionohet. Megjithatë, një përjashtim i rëndësishëm ka qenë debati me pjesëmarrjen e kandidatit Faton Peci nga LVV, ku përplasjet mes tij dhe analistit Halil Matoshi eskaluan në ofendime shumë të rënda, ku edhe pas ndaljes së mikrofonit disa herë, debati i ashpër nuk ndaloj, dhe

kandidati Faton Peci e la studion. Ky incident u veçua si momenti më i tensionuar i ciklit të debateve. Përndryshe, diskutimet kanë ndjekur një format të strukturuar.

Kandidatët janë përballur me pyetje kryesisht të njëjta në numër dhe përmbajtje.

Në disa raste vërehet mungesa e analizave të thelluara mbi programet politike të subjekteve garuese, duke u fokusuar më shumë te kritikën mbi punën e qeverisjeve të kaluara

Në dy emisione ka pasur vendosje të produkteve.

TËVË 1

Tëvë 1 gjatë 29 ditëve të fushatës elektorale ka pasur afër 3 orë kronika zgjedhore dedikuar aktiviteteve të subjekteve politike dhe mbi 55 orë debate televizive.

Kronika zgjedhore

Në kronikat zgjedhore të Tëvë 1, mbulimi i subjekteve politike dhe kandidatëve për kryeministër ka qenë i përqendruar kryesisht tek partitë kryesore, ndërsa subjektet e tjera kanë pasur një prani më të kufizuar.

- LDK** ka marrë mbulimin më të madh me 29 kronika për subjektin politik dhe 23 për kandidatin për kryeministër.
- PDK** ka pasur 28 kronika për subjektin politik dhe 26 për kandidatin për kryeministër.
- AAK-NISMA** ka marrë 27 kronika për subjektin politik dhe 22 për kandidatin për kryeministër.
- LVV** ka pasur 24 kronika për subjektin politik dhe 23 për kandidatin për kryeministër.
- Koalicioni për Familje** ka marrë 12 kronika për subjektin politik dhe 6 për liderin e subjektit.

Paraqitja e kandidatëve për deputetë sipas gjinisë




Në kronikat zgjedhore të Tëvë 1, numri i kandidatëve për deputetë të përmendur sipas gjinisë tregon një

dominim të theksuar të kandidatëve burra, ndërsa gratë kanë pasur një mbulim shumë të kufizuar.

- AAK-NISMA** ka marrë mbulimin më të madh për kandidatët burra, me 18 përmendje, ndërsa nuk ka pasur asnjë përmendje për gratë.
- LDK** ka pasur 11 përmendje për kandidatët burra dhe asnjë për kandidate gra.
- Koalicioni për Familje** ka pasur 8 përmendje për kandidatët burra dhe asnjë për kandidate gra.
- LVV** ka pasur 7 përmendje për kandidatët burra dhe 6 për kandidate gra, duke treguar një shpërndarje më të balancuar krahasuar me subjektet e tjera.
- PDK** ka pasur 6 përmendje për kandidatët burra dhe asnjë për kandidate gra.

Sa i përket hapësirës televizive në minuta, prin AAK-NISMA me 38 minuta, pasuar nga LVV me 37 minuta, PDK me 36 minuta, LDK me 35 minuta dhe Koalicioni për Familje me 15 minuta.

FIGURA 32 Kohëzgjatja në minuta e kronikave zgjedhore në Tëvë 1 sipas subjekteve politike




Kandidati për kryeministër nga LVV, Albin Kurti është kandidati me minutazhën më të gjatë në Tëvë 1 me gjithsej 10 minuta, ndjekur nga kandidati i PDK-së, Bedri Hamza me 8 minuta, Ramush Haradinaj nga AAK-NISMA me 7 minuta, Lumir Abdixhiku nga LDK me 6 minuta dhe Eman Rrahmani nga Koalicioni për Familje me 2 minuta.

Përderisa kandidatët për kryeministër kanë pasur 34 minuta hapësirë në kronikat zgjedhore, kandidatët e

tjerë për deputetë kanë pasur vetëm 15 minuta. Edhe në aspektin e kohëzgjatjes së paraqitjeve të kandidatëve, grave vërehet që u është dhënë shumë pak hapësirë në raport me kandidatët burra. Në këtë televizion kandidatet gra kur janë transmetuar në kronika, gjithmonë vetëm janë parafrazuar, përveç një herë kur një kandidate është transmetuar për 11 sekonda. Nga 15 minuta që janë paraqitur kandidatët për deputetë e gjithë kjo hapësirë ka qenë për kandidatët burra.

FIGURA 33 Krahasimi i hapësirës në minuta në kronikat zgjedhore në Tëvë 1



Debatet televizive


Tëvë 1 përgjatë periudhës 11 janar-8 shkurt, ka realizuar 41 debate televizive. Prej tyre 28 debate kanë qenë për prezantimin e një subjekti/kandidati, dhjetë kanë qenë debate vetëm me analistë, dy kanë qenë tjetër dhe një debat në mes dy subjekteve/kandidatëve.

Në debatet televizive të Tëvë 1, PDK ka marrë pjesë në dhjetë debate, LDK dhe Koalicioni AAK-NISMA në nga shtatë debate, LVV në katër debate, Koalicioni për Familje dhe Fjala në nga një debat.

Në debatet televizive kanë marrë pjesë gjithsej 35 kandidatë për deputetë, ku pjesëmarrja më e madhe ka qenë nga kandidatët e PDK-së me 11 pjesëmarrës, pasuar nga AAK-NISMA dhe LDK me nga tetë pjesëmarrës, LVV me katër, Koalicioni për Familje dhe Fjala me nga dy pjesëmarrës secila.

Nga 35 kandidatët pjesëmarrës 30 kanë qenë burra (86%) dhe 5 gra (14%).

FIGURA 34 Pjesëmarrja e kandidatëve për deputetë në debatet televizive të Tëvë 1 sipas gjinisë



Pjesë e debateve televizive në Tëvë 1 kanë 20 analistë me 73 paraqitje në total. Nga 20 analistë, 18 prej tyre kanë qenë burra (61 paraqitje), ndërsa dy gra (12 paraqitje).

Televizioni Tëvë 1 ka pasur një mbulim të gjerë të fushatës zgjedhore, ku janë transmetuar debate dhe analiza të shumta nga pjesëmarrës të partive politike dhe analistë të ndryshëm. Nga fillimi i fushatës më 11 janar deri në ditën e zgjedhjeve, emisionet si “Këndi i Debatit” dhe “Info Nata” kanë ofruar pasqyrë të gjerë mbi dinamizmin e fushatës dhe ndikimin e saj në politikën e Kosovës.

Analistët kanë kontribuar me vlerësime mbi ndikimin e fushatës në opinionin publik dhe mundësinë që partitë politike të realizojnë objektivat e tyre nëse fitojnë. Se si premtimet e partive politike ndikojnë në besueshmërinë dhe perceptimin e qytetarëve si dhe politikat e qeverisjes aktuale, ndikimin e saj në zgjedhje si dhe realizimin e premtimeve të bëra gjatë fushatës. Ndërkaq, partitë pjesëmarrëse kanë pasur mundësi të mbrojnë qëndrimet e tyre dhe të ofrojnë alternativa për zhvillimin e vendit. Ata më shumë kanë kritikuar qeverinë aktuale për dështimet sesa kanë ofruar diçka konkrete me programet e tyre megjithatë, kanë theksuar nevojën për ndryshime.

ATV


ATV gjatë 29 ditëve të fushatës elektorale ka pasur mbi gjashtë orë kronika zgjedhore dedikuar aktiviteteve të subjekteve politike dhe mbi 48 orë debate televizive.

Kronika zgjedhore

Në kronikat zgjedhore të ATV, mbulimi i subjekteve politike dhe kandidatëve për kryeministër ka qenë më i lartë për partitë kryesore, ndërsa subjektet më të vogla kanë pasur një mbulim minimal.

LVV ka marrë mbulimin më të madh me 29 kronika për subjektin politik dhe 27 për kandidatin për kryeministër. **LDK** dhe **PDK** kanë pasur nga 28 kronika për subjektin politik dhe 26 për kandidatin për kryeministër. **AAK-NISMA** ka marrë 28 kronika për subjektin politik dhe 20 për kandidatin për kryeministër. **Koalicioni për Familje** ka pasur 16 kronika për subjektin politik dhe 11 për liderin e subjektit. **IRDK - Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës** ka pasur 7 kronika për subjektin politik dhe 3 për liderin e subjektit. **Partia Liberale Egjiptiane** dhe Lista Serbe kanë marrë nga 1 kronikë për subjektin politik dhe 1 për liderin

Paraqitja e kandidatëve për deputetë sipas gjinisë



Në kronikat zgjedhore të ATV, numri i kandidatëve për deputetë të përmendur sipas gjinisë tregon një mbulim të pabarabartë, ku kandidatët burra kanë dominuar dukshëm mbi gratë.

- **AAK-NISMA** ka marrë mbulimin më të madh për kandidatët burra, me 38 përmendje, ndërsa për gratë ka pasur vetëm 8 përmendje.
- **Koalicioni për Familje** ka pasur 26 përmendje për kandidatët burra dhe asnjë për kandidate gra.
- **PDK** ka pasur 27 përmendje për kandidatët burra dhe 4 për kandidate gra.
- **LDK** ka pasur 19 përmendje për kandidatët burra dhe asnjë për kandidate gra.
- **LVV** ka pasur 16 përmendje për kandidatët burra dhe 14 për kandidate gra, duke treguar një shpërndarje më të balancuar krahasuar me subjektet e tjera.
- **Partia Liberale Egjiptiane** ka pasur 1 përmendje për kandidatët burra dhe 1 për kandidate gra.

Sa i përket hapësirës televizive në minuta, prin LVV me 87 minuta, pasuar nga LDK me 82 minuta, PDK me 81 minuta, AAK-NISMA me 79 minuta, Koalicioni për Familje me 43 minuta dhe IRDK me 11 minuta, Lista Serbe me 3 minuta dhe PLE me 2 minuta.


FIGURA 35 Kohëzgjatja në minuta e kronikave zgjedhore në ATV sipas subjekteve politike



Kandidati për kryeministër nga LDK, Lumir Abdixhiku është kandidati me minutazhën më të gjatë në ATV me gjithsej 36 minuta, ndjekur nga kandidati i PDK-së, Bedri Hamza me 26 minuta, Albin Kurti nga LVV me 25 minuta, Ramush Haradinaj nga AAK-NISMA me 18 minuta, Eman Rrahmani nga Koalicioni për Familje me shtatë minuta dhe tre liderët e subjekteve nga minoritetet me katër minuta.

Përderisa kandidatët për kryeministër kanë pasur 116 minuta hapësirë në kronikat zgjedhore, kandidatët e tjerë për deputetë kanë pasur vetëm 68 minuta. Edhe në aspektin e kohëzgjatjes së paraqitjeve të kandidatëve gra vërehet që u është dhënë shumë më pak hapësirë në raport me kandidatët burra. Nga 68 minuta që janë paraqitur kandidatët për deputetë, kandidatet gra janë paraqitur vetëm 10 minuta (15%), ndërsa kandidatët burra janë paraqitur me 58 minuta (85%).

FIGURA 36 Krahاسimi i hapësirës në minuta në kronikat zgjedhore në ATV



Debatet televizive

ATV përgjatë periudhës 11 janar-8 shkurt, ka realizuar 45 debate televizive. Prej tyre 19 kanë qenë për prezantimin e një subjekti/kandidati, dhjetë debate vetëm me analistë, nëntë debate me shumë subjekte/kandidatë dhe shtatë debate në mes dy subjekteve. Nga debatet me pjesëmarrës nga subjektet politike, në 13 raste është diskutuar për programin e partisë dhe në nëntë raste është diskutuar pjesërisht për programin e partisë.


Në debatet televizive të ATV-së, AAK-NISMA kanë marrë pjesë në 20 debate, PDK në 13 debate, Koalicioni për Familje në 11 debate, LVV në shtatë debate, LDK në pesë debate, Fjala në katër debate, Partia Balli Kom-

bëtar Demokrat Shqiptar, Nisma Qytetare për Drejtësi Popullore (Gradjanska Inicijativa Narodna Pravda) dhe Kandidati i Pavarur Fatmir Bytyqi në nga një debat.

Në debatet televizive kanë marrë pjesë gjithsej 76 kandidatë për deputetë, ku pjesëmarrja më e madhe ka qenë nga kandidatët e Koalicionit AAK-NISMA me 24 pjesëmarrës, pasuar nga PDK me 16, Koalicioni për Familje me 14, LVV dhe LDK me nga tetë pjesëmarrës, Fjala me katër, dhe dy partitë nga minoritetet me nga një.

Nga 76 kandidatët pjesëmarrës 63 kanë qenë burra (83%) dhe 13 gra (17%).

FIGURA 37 Pjesëmarrja e kandidatëve për deputetë në debatet televizive të ATV sipas gjinisë



Pjesë e debateve televizive në ATV kanë qenë 17 analistë me 47 paraqitje në total. Nga 47 analistë, 46 prej tyre kanë qenë burra (46 paraqitje), ndërsa një grua (një paraqitje).

Në 16 emisione ka pasur vendosje të produktit.

Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, ATV transmetoi dy emisione televizive, ku u zhvilluan diskutime me analistë politikë, ekspertë të fushave të ndryshme dhe përfaqësues/kandidatë politikë. Debatet u përqendruan në fusha kryesore si ekonomia, drejtësia, energjia, infrastruktura dhe politika e jashtme, duke ofruar një platformë për vlerësimin e punës së qeverisë. Pavarë-

sisht formatit të strukturuar të debateve, në disa raste përfaqësuesit politikë kanë përdorur gjuhë fyese dhe kanë ndërhyrë në mënyrë të vazhdueshme ndaj kundërshtarëve të tyre.

RADIO TELEVISIONI I KOSOVËS 2 (RTK 2)

RTK 2 gjatë 29 ditëve të fushatës elektorale ka pasur afër katër orë kronika zgjedhore dedikuar aktiviteteve të subjekteve politike dhe mbi katër orë debate televizive.

Kronika zgjedhore

Në kronikat zgjedhore të RTK 2, mbulimi i subjekteve politike dhe kandidatëve për kryeministër ose liderëve të subjekteve ka qenë i përqendruar kryesisht tek partitë kryesore, ndërsa subjektet e tjera kanë pasur një prani më të kufizuar.

AAK-NISMA ka marrë mbulimin më të madh me 44 kronika për subjektin politik dhe 35 për kandidatin për kryeministër.

LDK ka pasur 43 kronika për subjektin politik dhe 29 për kandidatin për kryeministër.

PDK ka pasur 40 kronika për subjektin politik dhe 30 për kandidatin për kryeministër.

LVV ka marrë 36 kronika për subjektin politik dhe 30 për kandidatin për kryeministër.

Srpska Lista ka marrë 33 kronika për subjektin politik dhe 23 për liderin e subjektit.

Srpska Demokratija dhe **Za Slobodu Pravdu i Opstanak** kanë pasur nga 27 kronika për subjektin politik dhe 20 dhe 5 për liderët e subjekteve, respektivisht.

Srpski Narodni Pokreta ka pasur 25 kronika për subjektin politik dhe 19 për liderin e subjektit.


Gradjanska Inicijativa Narodna Pravda ka marrë 17 kronika për subjektin politik dhe 7 për liderin e subjektit.

Partija Kosovskih Srba ka pasur 9 kronika për subjektin politik dhe asnjë për liderin e subjektit.

Koalicioni për Familje ka marrë 3 kronika për subjektin politik dhe 2 për liderin e subjektit.

Fjala ka pasur vetëm 1 kronikë për subjektin politik dhe asnjë për liderin e subjektit.

Paraqitja e kandidatëve për deputetë sipas gjinisë



Në kronikat zgjedhore të RTK 2, numri i kandidatëve për deputetë të përmendur sipas gjinisë tregon një dominim të theksuar të kandidatëve burra, ndërsa gratë kanë pasur një prani shumë të kufizuar.

● **Za Slobodu Pravdu i Opstanak** ka marrë mbulimin më të madh për kandidatët burra, me 15 përmendje, ndërsa për gratë ka pasur vetëm 7 përmendje.

● **LDK** ka pasur 13 përmendje për kandidatët burra dhe 1 për kandidate gra.

● **PDK** ka pasur 11 përmendje për kandidatët burra dhe asnjë për kandidate gra.


● **Gradjanska Inicijativa Narodna Pravda** ka pasur 9 përmendje për kandidatët burra dhe 1 për kandidate gra.

● **AAK-NISMA** ka pasur 9 përmendje për kandidatët burra dhe asnjë për kandidate gra.

- **Srpska Lista** ka pasur 8 përmendje për kandidatët burra dhe 2 për candidate gra.
- **Srpska Demokratija** ka pasur 5 përmendje për kandidatët burra dhe 2 për candidate gra.
- **Srpski Narodni Pokreta** ka pasur 7 përmendje për kandidatët burra dhe asnjë për candidate gra.
- **LVV** ka pasur 4 përmendje për kandidatët burra dhe 2 për candidate gra.
- **Koalicioni për Familje** dhe **Fjala** kanë pasur nga 1 përmendje për kandidatët burra dhe asnjë për candidate gra.

Sa i përket hapësirës televizive në minuta, prin Demokracia Serbe (Srpska demokratija) me 57 minuta, ndjekur nga Lista Serbe (Srpska lista) me 31 minuta, LDK me 24 minuta, AAK-NISMA me 23 minuta, Lëvizja Popullore Serbe (Srpski narodni pokret) me 22 minuta, PDK me 21 minuta, LVV me 19 minuta, Partia për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë (Za Slobodu Pravdu I Opstanak) me 13 minuta, Nisma Qytetare për Drejtësi Popullore (Gradjanska Inicijativa Narodna Pravda) me 12 minuta, Partia e Serbëve të Kosovës (Partija kosovskih Srba) me pesë minuta, Koalicioni për Familje me 2 minuta.


FIGURA 38 Kohëzgjatja në minuta e kronikave zgjedhore në RTK 2 sipas subjekteve politike



Kandidati për kryeministër nga AAK-NISMA, Ramush Haradinaj është kandidati me minutazhën më të gjatë në RTK 2 me 13 minuta, ndjekur nga kandidatët e LDK-së, PDK-së, LVV-së dhe Listës Serbe (Srpska lista) me nga 11 minuta, Branimir Stojanović nga Lëvizja Popullore Serbe (Srpski narodni pokreta) me dhjetë minuta, Aleksandar Arsenijović nga Demokracia Serbe (Srpska demokratija) me 9 minuta, Aleksandar Jablanović nga Partia e Serbeve të Kosovës (Partija kosovskih Srba) me 4 minuta, Nebojša Milić nga Nisma Qytetare për Drejtësi Popullore (Gradjanska Inicijativa Narodna Pravda) me 2

minuta dhe Nenad Rašić nga Partia për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë (Za Slobodu Pravdu I Opstanak) me 1 minut. Përderisa kandidatët për kryeministër kanë pasur 82 minuta hapësirë në kronikat zgjedhore, kandidatët e tjerë për deputetë kanë pasur 66 minuta. Edhe në aspektin e kohëzgjatjes së paraqitjeve të candidateve gra vërehet që u është dhënë shumë më pak hapësirë në raport me kandidatët burra. Nga 66 minuta që janë paraqitur kandidatët për deputetë, kandidatet gra janë paraqitur vetëm pesë minuta (8%), ndërsa kandidatët burra janë paraqitur me 61 minuta (92%)

FIGURA 39 Krahاسimi i hapësirës në minuta në kronikat zgjedhore në RTK 2



Krahاسimi i hapësirës në minuta në kronikat zgjedhore në RTK 2

Debatet televizive


Në RTK 2 gjatë fushatë zgjedhore janë mbajtur pesë debate televizive. Prej tyre, tri debate kanë qenë me shumë subjekte/kandidatë dhe dy kanë qenë për prezantimin e një subjekti/kandidati. Në pesë debatet e realizuara është paraqitur programi i partive pjesëmarrëse.

Në debatet televizive të RTK 2, Nisma Qytetare për Drejtësi Popullore (Gradjanska Inicijativa Narodna Pravda) dhe Lëvizja Popullore Serbe (Srpski narodni pokret) kanë marrë pjesë në nga katër debate, Partia për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë (Za Slobodu Pravdu I Opstanak) në tri debate dhe Demokracia Serbe (Srpska demokratija) në dy debate.

Në debatet televizive kanë marrë pjesë gjithsej 13 kandidatë për deputetë, ku pjesëmarrja më e madhe ka qenë nga kandidatët e Nisma Qytetare për Drejtësi Popullore (Gradjanska Inicijativa Narodna Pravda) dhe Lëvizja Popullore Serbe (Srpski narodni pokret) kanë marrë pjesë me nga katër kandidatë, Partia për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë (Za Slobodu Pravdu I Opstanak) me tre kandidatë dhe Demokracia Serbe (Srpska demokratija) me dy kandidatë.

Nga 13 kandidatët pjesëmarrës 9 kanë qenë burra (69%) dhe 4 gra (31%).

FIGURA 40 Pjesëmarrja e kandidatëve për deputetë në debatet televizive të RTK 2 sipas gjinisë



TV PULS

Tv Puls gjatë 29 ditëve të fushatës elektorale ka pasur 75 minuta kronika zgjedhore dedikuar aktiviteteve të subjekteve politike dhe 45 minuta debat zgjedhor.

Kronika zgjedhore

Në kronikat zgjedhore të TV Puls, mbulimi i subjekteve politike dhe kandidatëve për kryeministër ose liderëve të subjekteve ka qenë i përqendruar kryesisht tek Srpska Lista, ndërsa subjektet e tjera kanë pasur një prani minimale.

Srpska Lista ka marrë mbulimin më të madh me 36 kronika për subjektin politik dhe 17 për liderin e subjektit.


Za Slobodu Pravdu i Opstanak ka pasur 3 kronika si për subjektin politik ashtu edhe për liderin e subjektit.

LVV ka pasur 2 kronika për subjektin politik dhe 2 për kandidatin për kryeministër.

Srpska Demokratija ka marrë 2 kronika për subjektin politik dhe 2 për liderin e subjektit.

Partija Kosovskih Srba dhe **Srpski Narodni Pokreta** kanë marrë nga 1 kronikë për subjektin politik dhe 1 për liderin e subjektit.


Paraqitja e kandidatëve për deputetë sipas gjinisë



Të gjithë kandidatët për deputetë që janë transmetuar në TV Puls kanë qenë nga Lista Serbe (Srpska lista).

Sa i përket hapësirës televizive në minuta, prin Lista Serbe (Srpska lista) me 65 minuta, ndjekur nga Partia për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë (Za Slobodu Pravdu I Opstanak), Demokracia Serbe (Srpska demokratija) dhe Lëvizja Popullore Serbe (Srpski narodni pokret) me nga tre minuta, LVV dhe Partia e Serbëve të Kosovës (Partija kosovskih Srba) me nga një minutë.


FIGURA 41 Kohëzgjatja në minuta e kronikave zgjedhore në TV Puls sipas subjekteve politike



Lideri i Listës Serbe (Srpska lista), Zlatan Elek është kandidati me minutazhën më të gjatë në TV Puls me 15 minuta, ndjekur nga Nenad Rašić i Partisë për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë (Za Slobodu Pravdu i Opstanak) me tre minuta, Branimir Stojanović (Srpski narodni pokreta) dhe Aleksandar Arsenijović (Srpska demokratija) me nga dy minuta, Albin Kurti (LVV) me një minut dhe Aleksandar Jablanović (Partija kosovskih Srba) me më pak se një minut.

Përderisa liderët e subjekteve politike kanë pasur 24 minuta hapësirë në kronikat zgjedhore, kandidatët e tjerë për deputetë kanë pasur 13 minuta. Edhe në aspektin e kohëzgjatjes së paraqitjeve të kandidateve gra vërehet që u është dhënë shumë më pak hapësirë në raport me kandidatët burra. Nga 13 minuta që janë paraqitur kandidatët për deputetë, kandidatet gra janë paraqitur vetëm tre minuta (23%), ndërsa kandidatët burra janë paraqitur me dhjetë minuta (77%).

FIGURA 42 Krahاسimi i hapësirës në minuta në kronikat zgjedhore në TV Puls



Sa i përket debateve politike, TV Puls gjatë fushatës zgjedhore ka mbajtur vetëm një debat, ku është prezantuar


subjekti politik Lista Serbe (Srpska lista), ku kanë qenë të ftuar dy kandidatët Suzana Aleksić dhe Ivan Zaporožac.

TRANSMETIMET LIVE NË RRJETIN SOCIAL ‘FACEBOOK’

Gjatë fushatës zgjedhore janë monitoruar 15 faqe zyrtare të portaleve në Facebook (Albanian Post, Ekonomia Online, Gazeta Blic, Gazeta Express, Indeksonline, Insajderi, Kanal 10, Koha.net, Kosova Press, Nacionale, Paparaci, Periskopi, Sinjali, RTV Kim, TV Most). Këto portale kanë transmetuar 18304 minuta në faqet e tyre zyrtare, nga këto AAK-NISMA ka pasur 12353 minuta, LDK 3322 minuta, PDK 2264 minuta, LVV 358 minuta dhe 7 minuta subjektet tjera.

Portali Insjaderi është portali me minutazhën më të gjatë që ka transmetuar direkt aktivitetet e subjekteve politike gjatë fushatës me 2622 minuta, ndjekur nga Periskopi me 2464 minuta, Kanal 10 me 1872 minuta, Gazeta Blic me 1746 minuta, EkonomiaOnline me 1691 minuta dhe të tjerat së bashku me 7922 minuta.

FIGURA 43 Minutat e transmetimeve direkte sipas portaleve




Nga 521 transmetime direkte



vetëm për 104

prej tyre është cekur që janë transmetime me pagesë nga subjektet politike.

FIGURA 44 Krahاسimi mes transmetimeve direkte të sponsorizuara dhe atyre të pa sponsorizuara



Nga 521 transmetime direkte



253

prej tyre janë bërë share nga faqet e subjekteve politike apo kandidatëve për kryeministër.


MONITORIMI I FAQEVE ZYRTARE TË FACEBOOK-UT TË KANDIDATËVE PËR KRYEMINISTËR

DNV ka filluar monitorimin e faqeve zyrtare të Facebook-ut për kandidatët për kryeministër nga 1 shtatori, dy javë pas shpalljeve së datës së zgjedhjeve në Kosovë, periudhë kur vetëm kishte filluar intensifikimi i aktiviteteve të subjekteve politike në Kosovë.

Gjatë kësaj periudhe (1 shtator 2024 – 8 shkurt 2025) liderët e katër subjekteve të mëdha në Kosovë,

njëherësh kandidatët për kryeministër kanë pasur 1191 postime në faqet e tyre. Kandidati për kryeministër nga LDK, Lumir Abdixhiku ka pasur 382 postime, ndjekur nga kandidati i LVV, Albin Kurti me 284 postime, Bedri Hamza nga PDK me 280 postime dhe Ramush Haradinaj nga AAK-NISMA me 245 postime.

FIGURA 45 Postimet e kandidatëve për kryeministër në Facebook (1 shtator 2024-8 shkurt 2025)



Monitorimi i rrjetit social “Facebook” - Lumir Abdixhiku

Kandidati i LDK-së për kryeministër, Lumir Abdixhiku, si mjet kryesor të komunikimit ka përdorur foto albumet dhe videot për komunikim me elektorat. Nga 382 postime, 188 prej tyre janë foto albume ndërsa 97 janë video.

Sa i përket aktiviteteve, takimet me qytetarë dominojnë postimet e kandidatit të LDK-së, me 113 postime.

Monitorimi i rrjetit social “Facebook” - Albin Kurti

Edhe kandidati për kryeministër nga LVV si mjet kryesor të komunikimit ka përdorur foto albumet dhe videot për komunikim me elektorat. Nga 284 postime, 135 prej tyre janë foto albume ndërsa 80 janë video.

Sa i përket aktiviteteve, takimet me qytetarë dominojnë postimet e kandidatit të LVV-së, me 76 postime. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe kryeministri aktual ka pasur edhe 17 postime nga përrurimet e objekteve.

Monitorimi i rrjetit social “Facebook” - Bedri Hamza

Edhe kandidati për kryeministër nga PDK si mjet kryesor të komunikimit ka përdorur foto albumet dhe videot për komunikim me elektorat. Nga 280 postime, 138 prej tyre janë foto albume ndërsa 88 janë video.

Sa i përket aktiviteteve, takimet me qytetarë dominojnë postimet e kandidatit të PDK-së, me 72 postime, pasuar nga takimet me biznese me 23 postime.

Monitorimi i rrjetit social “Facebook” - Ramush Haradinaj

Edhe kandidati për kryeministër nga AAK-NISMA si mjet kryesor të komunikimit ka përdorur foto albumet dhe videot për komunikim me elektorat. Nga 245 postime, 127 prej tyre janë foto albume ndërsa 73 janë video.

Sa i përket aktiviteteve, takimet me qytetarë dominojnë postimet e kandidatit të AAK-së, me 60 postime, pasuar nga prezantimi i kandidatëve për deputetë me 17 postime.


MONITORIMI I FAQEVE ZYRTARE TË FACEBOOK-UT TË SUBJEKTEVE POLITIKE

Nga 11 janari deri më 8 shkurt, katër partitë e mëdha kanë postuar në faqet e tyre, 1615 postime. LVV ka pasur 403 postime, LDK 341 postime, PDK 249 postime dhe AAK-NISMA 110 postime, Koalicioni për Familje 98 postime, ndërsa subjektet tjera nga minoritetet kanë pasur 414 postime.

Edhe faqet zyrtare në Facebook të subjekteve politike janë përdorur kryesisht për promovimin e kandidatëve për kryeministër/liderët e subjekteve.

Nga 1481 postime që kanë qenë për anëtarët e subjekteve, 594 postime (40%) kanë qenë për kandidatët për kryeministër/liderët e subjekteve dhe 887 postime (60%) për kandidatët e tjerë.


FIGURA 46 Krahasoni i postimeve në mes liderëve dhe kandidatëve tjerë në faqet zyrtare të subjekteve politike



Sa i përket promovimit të kandidatëve tjerë, edhe në Facebook kandidatët burra kanë marrë më shumë hapësirë se kandidatet gra. Nga 887 postime ku janë promovuar kandidatët për deputetë, për kandidatët

burra janë bërë 586 postime (66%) ndërsa për kandidatët gra janë bërë 301 postime (34%).

FIGURA 47 Postimet në faqet zyrtare të SP për kandidatët për deputetë sipas gjinisë



JO-FUNKSIONALITETI I KOMISIONIT TË PAVARUR TË MEDIAVE GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE


Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), përgjatë fushatës ka vijuar të jetë jofunksional, dhe atë kryesisht për shkak të dështimit të Kuvendit të Kosovës për të emëruar me kohë anëtarët e rinj të KPM-së, duke e lënë institucionin pa kuorum edhe gjatë fushatës zgjedhore. Për shkak të mungesës së kuorumit, KPM nuk ka pasur mundësi të mbaj mbledhje për të vendosur për ankesat e bëra ndaj OShM-ve.

Për më tepër, gjatë kësaj kohe KPM ka ndërmarrë edhe një proces të kalimit në ueb-faqen e re, që ka shkaktuar vonesa në publikimin e informacioneve zyrtare.

DnV ka kërkuar qasje në ditarët e OShM-ve, të cilët do të duhej të dorëzoheshin çdo të hënë për javët paraqake. Megjithatë, një pjesë e OShM-ve nuk i kanë dorëzuar ditarët në kohën e paraparë, duke ngritur shqetësime për mungesë transparence dhe mosrespektim të rregulloreve në fuqi.

Gjatë periudhës së fushatës, KPM ka pranuar 28 ankesa. Nga këto ankesa 18 janë ankesa të dërguara nga PZAP në KPM, ndërsa 10 ankesa janë bërë nga publiku/palët.

FIGURA 48 Ankesat e përcjella nga PZAP dhe personat fizik apo juridik në KPM ndaj OShM-ve



Kryesisht, shkaqet e këtyre ankesave kanë qenë shpifja dhe nxitja e urrejtjes ndaj subjekteve politike, gjuha

denigruese dhe nxitëse ndaj komunitetit LGBT, si dhe shkelja e Kodit të Etikës.


MONITORIMI I DITARËVE TË DORËZUAR NË KPM NGA OSHM-ËT

Sipas ditarëve të dorëzuar nga OSHM-ët gjatë fushatë zgjedhore subjektet politike kanë shfrytëzuar 18 mijë e 150 minuta hapësirë televizive për reklamime. Nga këto 11 mijë e 141 minuta pa pagesë dhe 7 mijë e nëntë minuta me pagesë.

Hapësira më e madhe pa pagesë është shfrytëzuar në transmetuesin publike me 10 mijë e 536 minuta (7 mijë e 491 minuta në RTK 1 dhe 3 mijë e 45 minuta në RTK 2)

Sa i përket hapësirës me pagesë, në KTV ka pasur 2 mijë e 174 minuta reklamime ndjekur nga RTV Dukagjini me 1mijë e 226 minuta.

FIGURA 49 Hapësira në minuta e shfrytëzuar nga subjektet politike sipas OShM-ve



DITARËT E DORËZUAR NGA RADIO TELE-VIZIONI I KOSOVËS 1

Nga monitorimi i ditarëve të dorëzuar nga RTK në KPM rezulton që ky transmetues ka pasur 7745 minuta reklamime për subjektet politike. Nga këto 7491 minuta pa pagesë dhe 253 minuta me pagesë.

Më së shumti hapësirë pa pagesë ka shfrytëzuar PDK me 1313 minuta, ndjekur nga Koalicioni AAK-NISMA me 1301 minuta dhe LVV me 1156 minuta.

Sa i përket hapësirës me pagesë vetëm dy subjekte politike kanë reklamuar në RTK, LVV ka pasur 190 minuta reklamime ndërsa PDK 63 minuta.

Gjithashtu sipas ditarëve të dorëzuar rezulton që RTK më datën 8 shkurt 2025, ka transmetuar LVV gjithsej 91 minuta hapësirë me pagesë, e cila është në kundërshtim me ligjin, ku brenda një dite maksimumi i kohës së lejuar për një subjekt është 90 minuta

Në RTK, hapësira në minuta e ofruar për reklama gjatë fushatës zgjedhore sipas subjekteve politike ka qenë si më poshtë:

- **LVV** ka pasur 1238 minuta hapësirë pa pagesë dhe 190 minuta me pagesë.
- **LDK** ka marrë 1156 minuta pa pagesë.
- **AAK-NISMA** kanë shfrytëzuar 1301 minuta pa pagesë.
- **PDK** ka pasur 1313 minuta pa pagesë dhe 63 minuta me pagesë.
- **Koalicioni për Familje** ka marrë 287 minuta pa pagesë.
- **Koalicioni Boshnjak (Naša Bošnjačka Koalicija)** ka shfrytëzuar 180 minuta pa pagesë.
- **Koalicioni Vakrat (Koalicija Vakrat)** ka marrë 180 minuta pa pagesë.
- **Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP)** ka pasur 217 minuta pa pagesë.
- **Partia e Re Demokratike (NDS - Nova Demokratska Stranka)** ka marrë 194 minuta pa pagesë.
- **Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK)** ka pasur vetëm 67 minuta pa pagesë.
- **Fatmir Bytyqi** ka pasur 76 minuta pa pagesë.
- **Fjala** ka shfrytëzuar 63 minuta pa pagesë.

- **Iniciativa Qytetare Drejtësia e Popullit (Gradjanska Inicijativa Narodna Pravda)** ka marrë 39 minuta pa pagesë.
- **Demokracia Serbe (Srpska Demokratija)** ka pasur 20 minuta pa pagesë.
- **Për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë (Za Slobodu Pravdu i Opstanak)** ka marrë 5 minuta pa pagesë.
- **Partia e Serbëve të Kosovës (Partija Kosovskih Srba)** ka shfrytëzuar 9 minuta pa pagesë.
- **Koalicioni për Familje** ka pasur 3 minuta pa pagesë.

DITARËT E DORËZUAR NGA KOHAVISION

Nga monitorimi i ditarëve të dorëzuar nga KTV në KPM rezulton që ky transmetues ka pasur 2269 minuta reklamime për subjektet politike. Nga këto 95 minuta pa pagesë dhe 2174 minuta me pagesë.

Më së shumti hapësirë pa pagesë ka shfrytëzuar LDK me 19 minuta, ndjekur nga IRDK dhe PLE me nga 17 minuta.

Sa i përket hapësirës me pagesë, LVV ka pasur 1517 minuta reklamime ndërsa PDK 650 minuta.

Në KTV, hapësira në minuta e ofruar për reklama gjatë fushatës zgjedhore sipas subjekteve politike ka qenë si më poshtë:

- **LVV** ka shfrytëzuar 1517 minuta me pagesë dhe 9 minuta pa pagesë.
- **PDK** ka marrë 650 minuta me pagesë dhe 18 minuta pa pagesë.
- **LDK** ka pasur 1 minut me pagesë dhe 19 minuta pa pagesë.
- **AAK-NISMA** ka shfrytëzuar 7 minuta me pagesë.
- **Koalicioni për Familje** ka marrë 16 minuta pa pagesë.
- **PLE - Partia Liberale Egjiptiane** ka marrë 17 minuta pa pagesë.
- **Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK)** ka pasur 17 minuta pa pagesë .

DITARËT E DORËZUAR NGA KLAN KOSOVA

Nga monitorimi i ditarëve të dorëzuar nga KlanKosova në KPM rezulton që ky transmetues ka pasur 681 minuta reklamime për subjektet politike. Nga këto 233 minuta pa pagesë dhe 449 minuta me pagesë.

Më së shumti hapësirë pa pagesë ka shfrytëzuar LDK me 98 minuta, ndjekur nga PDK me 66 minuta dhe Koalicioni AAK-NISMA me 30 minuta.

Sa i përket hapësirës me pagesë, PDK ka pasur 227 minuta reklamime ndërsa LDK 178 minuta. Gjithashtu sipas ditarëve të dorëzuar rezulton që KlanKosova më datën 11 janar 2025, ka transmetuar PDK-në gjithsej 124 minuta hapësirë me pagesë, e cila është në kundërshtim me ligjin, ku brenda një dite maksimumi i kohës së lejuar për një subjekt është 90 minuta.

Në Klan Kosova, hapësira në minuta e ofruar për reklama gjatë fushatës zgjedhore sipas subjekteve politike ka qenë si më poshtë:

- **PDK** ka shfrytëzuar 227 minuta me pagesë dhe 66 minuta pa pagesë.
- **LDK** ka marrë 178 minuta me pagesë dhe 98 minuta pa pagesë.
- **AAK-NISMA** ka pasur 24 minuta me pagesë dhe 30 minuta pa pagesë.
- **Koalicioni për Familje** ka shfrytëzuar 20 minuta me pagesë dhe 25 minuta pa pagesë.
- **PLE - Partia Liberale Egjiptiane** ka marrë 13 minuta pa pagesë.

DITARËT E DORËZUAR NGA RADIO TELE-VIZIONI 21

Nga monitorimi i ditarëve të dorëzuar nga RTV 21 në KPM rezulton që ky transmetues ka pasur 408 minuta reklamime për subjektet politike. Nga këto 47 minuta pa pagesë dhe 361 minuta me pagesë.

Më së shumti hapësirë pa pagesë ka shfrytëzuar PDK me 32 minuta, ndjekur nga LDK me 8 minuta.

Sa i përket hapësirës me pagesë, PDK ka pasur 338 minuta reklamime ndërsa LDK 15 minuta dhe Koalicioni AAK-NISMA 8 minuta.

Në RTV 21, hapësira në minuta e ofruar për reklama gjatë fushatës zgjedhore sipas subjekteve politike ka qenë si më poshtë:

- **PDK** ka shfrytëzuar 338 minuta me pagesë dhe 32 minuta pa pagesë.
- **LDK** ka marrë 15 minuta me pagesë dhe 8 minuta pa pagesë.
- **AAK-NISMA** ka pasur 8 minuta me pagesë.
- **Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK)** ka pasur 2 minuta pa pagesë.
- **PLE - Partia Liberale Egjiptiane** ka marrë 2 minuta pa pagesë.

DITARËT E DORËZUAR NGA RTV DUKAGJINI

Nga monitorimi i ditarëve të dorëzuar nga RTV Dukagjini në KPM rezulton që ky transmetues ka pasur 1314 minuta reklamime për subjektet politike. Nga këto 88 minuta pa pagesë dhe 1226 minuta me pagesë.

Më së shumti hapësirë pa pagesë ka shfrytëzuar Koalicioni AAK-NISMA me 37 minuta, ndjekur nga LDK me 27 minuta.

Sa i përket hapësirës me pagesë, PDK ka pasur 508 minuta reklamime ndërsa LDK 397 minuta dhe Koalicioni AAK-NISMA 289 minuta.

Në RTV Dukagjini, hapësira në minuta e ofruar për reklama gjatë fushatës zgjedhore sipas subjekteve politike ka qenë si më poshtë:

- **PDK** ka shfrytëzuar 507 minuta me pagesë.
- **LDK** ka marrë 397 minuta me pagesë dhe 27 minuta pa pagesë.
- **AAK-NISMA** ka pasur 289 minuta me pagesë dhe 37 minuta pa pagesë.
- **Koalicioni për Familje** ka marrë 32 minuta me pagesë dhe 13 minuta pa pagesë.
- **PLE - Partia Liberale Egjiptiane** ka marrë 11 minuta pa pagesë.

DITARËT E DORËZUAR NGA T7

Nga monitorimi i ditarëve të dorëzuar nga T7 në KPM rezulton që ky transmetues ka pasur 934 minuta reklamime për subjektet politike. Nga këto 18 minuta pa pagesë dhe 915 minuta me pagesë.

Hapësirë pa pagesë në këtë televizion ka shfrytëzuar vetëm PLE me 18 minuta

Sa i përket hapësirës me pagesë, LDK ka pasur 342 minuta reklamime ndërsa PDK 294 minuta dhe Koalicioni AAK-NISMA 252 minuta.

Në T7, hapësira në minuta e ofruar për reklama gjatë fushatës zgjedhore sipas subjekteve politike ka qenë si më poshtë:

- **LDK** ka shfrytëzuar 342 minuta me pagesë.
- **PDK** ka marrë 294 minuta me pagesë.
- **AAK-NISMA** ka pasur 253 minuta me pagesë.
- **Koalicioni për Familje** ka marrë 26 minuta me pagesë.
- **PLE - Partia Liberale Egjiptiane** ka marrë 18 minuta pa pagesë.

DITARËT E DORËZUAR NGA KANAL 10

Nga monitorimi i ditarëve të dorëzuar nga Kanal 10 në KPM rezulton që ky transmetues ka pasur 950 minuta reklamime për subjektet politike. Nga këto 74 minuta pa pagesë dhe 877 minuta me pagesë.

Më së shumti hapësirë pa pagesë ka shfrytëzuar LDK me 34 minuta, ndjekur nga Koalicioni AAK-NISMA me 29 minuta.

Sa i përket hapësirës me pagesë, Koalicioni AAK-NISMA ka pasur 347 minuta reklamime, LDK 300 minuta, PDK 183 minuta.

Në Kanal 10, hapësira në minuta e ofruar për reklama gjatë fushatës zgjedhore sipas subjekteve politike ka qenë si më poshtë:

- **LDK** ka shfrytëzuar 300 minuta me pagesë dhe 34 minuta pa pagesë.
- **PDK** ka marrë 183 minuta me pagesë dhe 2 minuta pa pagesë.

- **AAK-NISMA** ka pasur 347 minuta me pagesë dhe 29 minuta pa pagesë.
- **LVV** ka marrë 12 minuta me pagesë.
- **Koalicioni për Familje** ka marrë 36 minuta me pagesë dhe 1 minutë pa pagesë.
- **PREBK** ka marrë 8 minuta pa pagesë.

DITARËT E DORËZUAR NGA TËVË 1

Nga monitorimi i ditarëve të dorëzuar nga Kanal 10 në KPM rezulton që ky transmetues ka pasur 679 minuta reklamime për subjektet politike. Nga këto 50 minuta pa pagesë dhe 629 minuta me pagesë.

Më së shumti hapësirë pa pagesë ka shfrytëzuar LVV me 11 minuta, ndjekur nga Koalicioni për Familje me 9 minuta.

Sa i përket hapësirës me pagesë, LVV ka pasur 400 minuta reklamime dhe PDK 229 minuta

Në Tevë 1, hapësira në minuta e ofruar për reklama gjatë fushatës zgjedhore sipas subjekteve politike ka qenë si më poshtë:

- **LVV** ka shfrytëzuar 400 minuta me pagesë dhe 11 minuta pa pagesë.
- **PDK** ka pasur 229 minuta me pagesë.
- **Koalicioni për Familje** ka shfrytëzuar 9 minuta pa pagesë.
- **LDK** ka marrë 7 minuta pa pagesë.
- **IRDK** ka marrë 7 minuta pa pagesë.
- **Fjala** ka marrë 7 minuta pa pagesë.
- **PLE** ka marrë 9 minuta pa pagesë.

DITARËT E DORËZUAR NGA RADIO T ELEVIZIONI I KOSOVËS 2

Nga monitorimi i ditarëve të dorëzuar nga RTK 2 në KPM rezulton që ky transmetues ka pasur 3045 minuta reklamime për subjektet politike. E gjithë hapësira e shfrytëzuar në këtë televizion ka qenë pa pagesë.

Në RTK2, hapësira në minuta e ofruar për reklama gjatë fushatës zgjedhore sipas subjekteve politike ka qenë si më poshtë:

- **Koalicioni Boshnjak (Naša Bošnjačka Koalicija)** – 227 minuta.
- **Drejtësia Popullore (Narodna Pravda)** – 253 minuta.
- **NDS** – 259 minuta.
- **SPO** – 237 minuta.
- **Lëvizja Kombëtare Serbe (Srpski Narodni Pokret)** – 238 minuta.
- **Koalicioni Vakati (Koalicija Vakati)** – 227 minuta.
- **SDU** – 227 minuta.
- **PAI** – 172 minuta.
- **YTHP** – 135 minuta.
- **Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP)** – 135 minuta.
- **Roma të Bashkuar të Kosovës (Opre Roma Kosova)** – 128 minuta.
- **PREBK** – 93 minuta.
- **Partia Demokratike Turke e Kosovës (KATP)** – 93 minuta.
- **PDAK-LPB** – 215 minuta.
- **PDK** – 16 minuta.
- **LDK** – 16 minuta.
- **LVV** – 14 minuta.
- **Koalicioni për Familje** – 3 minuta.
- **Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK)** – 40 minuta.
- **Partia Liberale Egjiptiane (PLE)** – 66 minuta.
- **Partia Kosovare e Serbëve (PKS)** – 5 minuta.
- **Fjala** – 2 minuta.
- **AAK-NISMA** – 16 minuta.

DITARËT E DORËZUAR NGA TV PULS

Nga monitorimi i ditarëve të dorëzuar nga TV Puls në KPM rezulton që ky transmetues ka pasur 125 minuta reklamime. E gjithë hapësira televizive ka qenë me pagesë dhe është shfrytëzuar nga Lista Serbe (Srpska lista)

REKOMADIME

Nga të gjeturat e këtij raporti, DnV ofron këto rekomandime:

- Të sigurohet që përfaqësimi i kandidatëve dhe subjekteve politike të jetë proporcional dhe i drejtë, duke garantuar trajtim të barabartë dhe hapësirë të njëjtë për të gjithë akterët politik.
- Të shmangen lajmet e njëanshme dhe jo objektive, si dhe gjuha e urrejtjes në përmbajtjet mediatike, në përputhje me parimet profesionale dhe etike të gazetarisë.
- Të përshpejtohet procesi i emërimit të anëtarëve të rinj të Komisionit të Pavarur të Mediave, në mënyrë që të filloj funksionimi i këtij institucioni.
- Të rritet mbikëqyrja ndaj mediave tradicionale dhe online që nuk respektojnë standardet profesionale, duke zbatuar masa të qarta dhe efektive për garantimin e llogaridhënies dhe cilësisë së informacionit.
- Të sigurohet që financimi i mediave, përfshirë reklamën politike, të jetë transparent dhe i monitoruar nga organet përkatëse për të shmangur ndikimin e grupeve të interesit dhe kontrollin politik mbi përmbajtjen mediatike.
- KPM të sigurojë udhëzime të qarta dhe trajnime për OSHM-të lidhur me mënyrën e saktë të përgatitjes së ditarëve të transmetimit dhe dorëzimit të tyre sipas rregullave të përcaktuara.



Demokracia në Veprim
Demokratija na Delu
Democracy in Action